

LUMNIJE METANOVIQ

ARTAN HAXHI

TEFË TOPALLI

BOTA E FJALËVE

GJUHA SHQIPE 7

PËR KLASËN E SHTATË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT/ES

PODGORICË, 2025

Lumnije Metanoviq, dr. Artan Haxhi, dr. Tefë Topalli

BOTA E FJALËVE

GJUHA SHQIPE 7

për klasën e shtatë të shkollës fillore

Libri i mësuesit

SVIJET RIJEČI

ALBANSKI JEZIK 7

Za sedmi razred osnovne škole

Priručnik

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor: Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës: Llazo Leković

Redaktor: Dimitrov Popović

Recensentë: Mr. Sehad Lulanaj

Ali Daci

Valbona Hoxhiq

Dr. Fatmair Vadahej

Dr. Mitat Hoxha

Lektor: Sidorela Berishaj

Korrektor: Mr. Marjan Lulgjuraj

Dizajni dhe faqosja: Momçillo Qorsovici

Ilustrimet: Mersiha Rusulbegović

Redaktore teknike: Dajana Vukçević

Tirazhi:

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2574-8
COBISS.CG-ID 36422916

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 08/2-119/25-7446-8, datë 16.7.2025,
e ka miratuar këtë Komplet të tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.
Copyright c Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2025

**- PERMBAJTA -
LIBËR MËSUESI**

I. BISEDA

Planifikimi ditor 1	6
Planifikimi ditor 2	8
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	11

II. PËREMRI

Planifikimi ditor 3	12
Planifikimi ditor 4	15
Planifikimi ditor 5	17
Planifikimi ditor 6	19
Planifikimi ditor 7	22
Planifikimi ditor 8	25
Planifikimi ditor 9	27
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	30

III. LAJMI

1. Planifikimi ditor 10	31
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	34

IV. FOLJA

Planifikimi ditor 11	35
Planifikimi ditor 12	38
Planifikimi ditor 13	41
Planifikimi ditor 14	43
Planifikimi ditor 15	45
Planifikimi ditor 16	47
Planifikimi ditor 17	49

V. LAJMËRIMI PUBLIK

1. Planifikimi ditor 18	51
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	53

VI. NDAJFOLJA

1. Planifikimi ditor 19	54
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	57

VII. RAPORTI

1. Planifikimi ditor 20	58
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	61

VIII. PARAFJALA

1. Planifikim ditor 21	62
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	65

IX. LIDHËZA

Planifikimi ditor 22	66
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	69

X. BIOGRAFIA

1. Planifikimi ditor 23	70
2. Planifikimi ditor 24	73
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	76
XI. PJESEZA	
1. Planifikimi ditor 25	77
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	80
XII. PASTHIRRMA	
1. Planifikimi ditor 26	81
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	84
XIII. FTESA	
Planifikimi ditor 27	85
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	88
XIV. NDRYSHIMET TINGULLORE	
Planifikimi ditor 28	89
Planifikimi ditor 29	91
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	94
XV. FJALIA	
Planifikimi ditor 30	95
Planifikimi ditor 31	98
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	101
XVI. ARSYETIMI	
1. Planifikimi ditor 32	102
2. Planifikimi ditor 33	104
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	107
XVII. PËRCAKTORI	
1. Planifikimi ditor 34	108
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	111
XVIII. RRETHANORI	
Planifikimi ditor 35	112
Planifikimi ditor 36	114
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	117
XIX. GJUHA POPULLORE	
1. Planifikimi ditor 37	118
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	121
XX. KUNDRINORI	
1. Planifikimi ditor 38	122
2. Planifikimi ditor 39	126
Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli	128
XXI. VLERËSIM I NJOHURIVE	
TEST NR. 1	129
TEST NR. 2	131
TEST NR. 3	133

TEST NR. 4	135
TEST NR. 5	137
TEST NR. 6	139
TEST NR. 7	140

Planifikim ditor 1

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Biseda.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, tabela, shkumësi etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, bashkëbisedim, druri problemit;

Fjalët kyçe: bisedë, temë etj.

Arritjet e të nxënit:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:
- të kuptojë bisedat e dëgjuara (dhe të ekranizuara) të incizuara;

Veprimtaritë e nxënësve:

- përgjigjen pyetjeve të përgatitura në power point;
- dallojnë dhe identifikojnë bisedën;
- përcaktojnë temën e bisedës;
- zbatojnë metodën druri i problemit;
- punojnë në çifte detyrat e dhëna;
- në fletore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve të paraqitura në power point;
- jep shpjegime të qarta dhe të kuptueshme për temën e bisedës;
- udhëzon nxënësit të punojnë me metodën druri i problemit;
- ndan nxënësit në çifte dhe jep detyrat;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime shtesë kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – Stuhi mendimesh/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësuesi/ja shfaq në televizor pyetjet e përgatitura në power point.

Nxënësit i lexojnë me kujdes dhe u përgjigjen pyetjeve, me ndihmën dhe udhëzimin e mësuesit/es.

Realizim kuptimi

Hapi I – Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë: Biseda.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor, dhe ndjekin me vëmendje shpjegimin e mësimdhënësit.

Biseda është një formë e komunikimit midis dy ose më shumë njerëzve, që shërben për të shkëmbyer mendime, ide, informacione, emocione ose përvoja jetësore. Biseda është një pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme.

Bisedat e rastit janë ato biseda që ndodhin pa ndonjë planifikim të veçantë, thjesht realizohen në një moment dhe në një situatë të caktuar.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi vazhdon të sqarojë përmes pyetjeve dhe përgjigjeve për temën e bisedës, si dhe karakteristikat e bisedave të rastit.

Nxënësit bëjnë pyetje lidhur me bisedat e rastit.

Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve për të vështuar dhe analizuar shembujt e dhënë.

Hapi III - Druri i problemit

Nxënësit në çifte shkruajnë një bisedë të rastit duke u bazuar te karakteristikat e saja.

Lexojnë bisedat dhe komentojnë me njëri-tjetrin.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Pyetje:

1. Ç'është biseda dhe për çfarë shërben ajo?
2. Cilat janë llojet kryesore të bisedave?
3. Ç'janë bisedat e rastit?
4. Ku mund të realizohen ato?
5. Cilat janë karakteristikat e bisedave të rastit?
6. Ç'është tema e bisedës?
7. Cilat janë disa nga tiparet e saj?
8. Nga se përcaktohet tema e bisedës?
9. Kush mund të jetë temë e bisedës?

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit në fletore u përgjigjen pyetjeve.

Nxënësit pasi t'i përfundojnë ushtrimet i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një bisedë të rastit.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 2

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Biseda formale dhe joformale.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, tabela etj;

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari dypjesësh, stuhi mendimesh, diagrami i Venit;

Fjalët kyçe: bisedë formale/zyrtare, joformale/jozyrtare etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:
- të zhvillojë një bisedë telefonike zyrtare dhe jozyrtare;
- të vlerësojë bisedën si zyrtare/jozyrtare;
- të përcaktojë temën dhe bashkëbiseduesin;

Veprimtaritë e nxënësve:

- plotësojnë ditarin dypjesësh;
- identifikojnë bisedën formale dhe joformale;
- lexojnë bisedat nga teksti mësimor;
- plotësojnë diagramin e Venit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin dypjesësh;
- shpjegon për bisedën formale (zyrtare), joformale (jozyrtare);
- fton nxënësit të lexojnë bisedat nga teksti mësimor;
- fton nxënësit të plotësojnë diagramin e Venit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – Ditari dypjesësh/ Veprimtari paraprake

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin dypjesësh.

Shkruan pyetjet dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Pyetja	Përgjigje
Çka është biseda e rastit? Cilat janë karakteristikat? Çfarë është tema e bisedës?	

Nxënësit me kujdes plotësojnë ditarin dypjesësh me ndihmën e mësimitdhënësit.


Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimitdhënësi shkruan titullin në tabelë : Biseda formale dhe joformale.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimitdhënësit.




Mësimitdhënësi vazhdon të sqaroj përmes pyetjeve dhe përgjigjeve për format e bisedave formale dhe joformale.

Nxënësit lexojnë me kujdes bisedat formale dhe joformale nga teksti mësimor.

Hapi II - Diagrami i Venit

Mësimitdhënësi vizaton diagramin e Venit në tabelë dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë diagramin e Venit duke shkruar ndryshimet.



Hapi III - Punë në grupe

Mësimitdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I – Shkruani një bisedë formale;

Grupi II – Shkruani një bisedë joformale;

Grupi III – Shkruani një bisedë formale;

Grupi IV – Shkruani një bisedë joformale;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimitdhënësi.

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ush-

trimeve. Pyetje:

1. Ç'janë bisedat formale?
2. Cilat janë disa nga tiparet e tyre?
3. Cilat janë disa nga format kryesore të bisedave formale?
4. Ç'janë bisedat joformale?
5. Cilat janë disa nga tiparet e tyre?
6. Cilat janë disa nga format kryesore të bisedave joformale?
7. Jepni shembuj të një bisede zyrtare.
8. Jepni shembuj të një bisede jozyrtare.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve me kujdes në fletore dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një bisedë sipas dëshirës.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim i nxënësve sipas niveleve pas çdo kapitulli.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë bisedën;
- emërtojnë temën e bisedës;
- përkufizojnë bisedën formale dhe joformale.

Niveli i mesëm

- dallojnë karakteristikat e bisedës;
- dallojnë bisedën formale;
- dallojnë bisedën joformale.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë një bisedë duke u nisur nga karakteristikat;
- krijojnë një bisedë formale dhe joformale.

Aktivitetet e mësimit

- në tekst vërejnë bisedën formale dhe joformale;
- ushtrojnë llojet e bisedave;
- komentojnë për llojet e bisedave;
- dallojnë dhe krijojnë biseda formale dhe joformale.

Detyrat për të kontrolluar

- Detyra plotësuese;
- Detyra saktë/pasaktë;
- Detyra rutinë (pyetje përgjigje)
- Detyra nga libri;
- Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 3

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Përemri vetvetor.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, tabela, fletëzat, shkumësi, etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: pema e mendimit, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: vetor, vetvetor, etj.

Arritjet e të nxënit:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë dhe të sqarojë disa lloje të përemrit;
- përemrat vetvetorë;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën pema e mendimit;
- identifikojnë përemrin vetvetor;
- lexojnë fjalitë nga teksti mësimor;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë pemën e mendimit;
- shpjegon përemrin vetvetor;
- fton nxënësit të lexojnë fjalitë nga teksti mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndërhyr sipas nevojës;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim


Hapi I – Pema e mendimit/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi në mes të tabelës shkruan fjalën Përemri dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit me llojet e përemrave.

Nxënësit përmes pemës së mendimit kujtojnë llojet e përemrave dhe ndalen të përemri vetvetor.



Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor.

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë : Përemri vetvetor.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përemri vetvetor është ai lloj përemri që tregon vetën (ose personin) që e kryen dhe njëkohësisht e pëson një veprim.

Hapi II – Stuhi mendimesh

Nxënësit lexojnë me vëmendje fjalitë nga teksti mësimor dhe nënvizojnë përemrat vetvetorë.

Shikojnë me kujdes ushtrimet dhe bëjnë pyetje sipas nevojës duke bashkëbiseduar me njëri-tjetrin. Mësimdhënësi vazhdon të sqarojë ushtrimet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 3 fjali me përemra vetvetorë në rase të ndryshme.

Grupi II - Krijoni 5 fjali me përemra vetvetorë në rase të ndryshme.

Grupi III - Krijoni 4 fjali dhe nënvizoni përemrat vetvetorë.

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni përemrat vetvetorë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtri-

meve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes ushtrimet dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për përemrin vetvetor.

Detyrë shtëpie: Shkruani 6 fjali dhe nënvizoni përemrat vetvetorë.

Vërejtjet e mësuesi/es për realizimin: _____

Planifikim ditor 4

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Përemri dëftor.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, tabela, shkumësi, fletëzat etj.;

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh; di dua të di, mësova, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: rasë, dëftor etj..

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë dhe të sqarojë disa lloje të përemrit;
- përemrat dëftorë.

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me teknikën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë përemrin dëftor;
- punojnë me teknikën rrjeti i diskutimit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën dua, dua të di, mësova;
- shpjegon përemrin dëftor;
- fton nxënësit të punojnë me teknikën rrjeti i diskutimit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndërhyr sipas nevojës;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Përemri dëftor.	Përemrin vetvetor.	Për përemrin dëftor.	

Nxënësit plotësojnë tabelën di, dua të di, kurse mësova në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi

Hapi I – Informacion i re/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Përemri dëftor

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përemrat dëftorë janë fjale që shërbejnë për të treguar sende apo frymorë që ndodhen pranë apo larg folësit.

Këto përemra përdoren bashkë me emrin ose e zëvendësojnë atë.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po

Jo

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Fton nxënësit të lexojnë në heshtje fjalitë nga teksti mësimor dhe të dallojnë përemrat dëftorë. Nxit nxënësit të përgjigjen pyetjeve përmes rrjetit të diskutimit.

Nxënësit shikojnë me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor dhe bëjnë pyetje sipas nevojës. Mësimdhënësi sqaron ushtrimet.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 3 fjali me përemra dëftorë në rase të ndryshme.

Grupi II - Krijoni 5 fjali me përemra dëftorë në rase të ndryshme.

Grupi III - Krijoni 4 fjali dhe nënvizoni përemrat dëftorë.

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni përemrat dëftorë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve. Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin. Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për përemrin dëftor.

Detyrë shtëpie: Shkruani 6 fjali dhe nënvizoni përemrat dëftorë.

Vërejtjet e mësimdhënësi për realizimin: _____

Planifikim ditor 5

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Përemri pronor.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, televizori, etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh,

Fjalët kyçe: veta, njëjës, shumës etj.

Arritjet e të nxënës:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë dhe sqarojë disa lloje të përemrit:
- përemrat pronor;

Veprimtaritë e nxënësve:

- përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- identifikojnë përemrin pronor;
- lexojnë fjalitë nga teksti mësimor;
- në grupe punojnë detyrat e dhëna;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- shpjegon përemrin pronor;
- fton nxënësit të lexojnë fjalitë nga teksti mësimor dhe të dallojnë përemrat pronorë;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – Stuhi mendimesh /Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi lëshon në televizor pyetjet e përgatitura me power point.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve me ndihmën e mësimdhënësit.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Përemri pronor.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përemri pronor është ai lloj përemri që tregon se kujt përket diçka, p.sh.: djali im, vajza jote, qëndrimi yt, shoku i tij etj.

Përemrat pronorë kanë tri veta për njëjës dhe tri për shumës.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po

Jo

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Fton nxënësit të lexojnë në heshtje pjesën dhe të gjejnë përemrat pronorë, të tregojnë gjininë, numrin dhe rasën e tyre. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve përmes teknikës rrjeti i diskutimit lidhur me përemrin pronor. Mësimdhënësi jep sqarime për pyetjet dhe paqartësitë e nxënësve.

Hapi III – Punë në grupe

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 3 fjali me përemra pronorë.

Grupi II - Krijoni 5 fjali me përemra pronorë.

Grupi III - Krijoni 4 fjali dhe nënvizoni përemrat pronorë.

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni përemrat pronorë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve. Fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat në fletore dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për përemrin pronor.

Detyrë shtëpie: Shkruani 7 fjali dhe nënvizo përemrat pronorë.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 6

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Lakimi i përemrit pronor.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: pema e mendimit, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: lakim, pronor etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë dhe sqarojë disa lloje të përemrit:
- përemrat pronorë

Veprimtaritë e nxënësve:

- plotësojnë pemën e mendimit;
- lexojnë pjesën nga teksti mësimor dhe mundohen të dallojnë format e ndryshme sipas rasave;
- në grupe punojnë detyrat e dhëna;
- në fletore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë pemën e mendimit;
- shpjegon lakimin e përemrit pronor;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor dhe të dallojnë format e ndryshme sipas rasave;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit


Evokim

Hapi I - Pema e mendimit /Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi në mes të tabelës shkruan Përemri pronor dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit me ndihmën e mësimit dhe kujtojnë përemrin pronor.



Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Lakimi i përemrit pronor.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përemrat pronorë kanë edhe kategorinë gramatikore të rasës. Ata mund të përdoren në bashkëvjajtje me emra ose në vend të tyre, si të emëruar kontekstualisht

Këto përemra përdoren bashkë me emrin ose e zëvendësojnë atë.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Ky aktivitet realizohet në bashkëbisedim mësimdhënëës-nxënës përmes pyetjeve dhe përgjigjeve.

Fton nxënësit të lexojnë tekstin dhe të gjejnë përemrat pronorë dhe të dallojnë format e ndryshme sipas rasave.

Nxënësit shkruajnë në fletoren shkollore disa shembuj dhe i komentojnë. Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 5 fjali me përemrin pronor **e tua** duke e përdorur në rase të ndryshme.

Grupi II - Krijoni 5 fjali me përemrin pronor **e mi** duke e përdorur në rase të ndryshme.

Grupi III - Krijoni 4 fjali dhe nënvizoni përemrat pronorë, shkruani rasën.

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni përemrat pronorë të përdorur në rase të ndryshme. Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve. Fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat në fletore dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura lakimin e përemrit pronor.

Detyrë shtëpie: Shkruani 6 fjali dhe nënvizo përemrat dëftorë.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 7

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Përemri pyetës.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh; di dua të di, mësova, ditari dypjesësh;

Fjalët kyçe: rasë, gjini, pyetës etj.

Arritjet e të nxënësve:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë dhe sqarojë disa lloje të përemrit;
- përemrat pyetës;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë përemrin pyetës;
- plotësojnë ditarin dypjesësh;
- në grupe punojnë detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon përemrin pyetës;
- fton nxënësit të plotësojnë ditarin dypjesësh;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova /Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Përemri pyetës.	Përemrin vetvetor, pronor, dëftor.	Për përemrin pyetës.	

Nxënësit plotësojnë tabelën di, dua të di, kurse mësova në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Përemri pyetës

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përemri pyetës është ai lloj përemri i cili përdoret për të pyetur për frymorë e sende ose për sasinë a tiparet e tyre.

Përemrat pyetës janë: kush, cili, ç', çfarë, sa, i sati dhe se.

Hapi II - Ditari dypjesësh

Mësimdhënësi vizaton ditarin dypjesësh dhe fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor.

Nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit plotësojnë ditarin dypjesësh.

Detyra	Përgjigjja
Nxënësit lexojnë pjesën nga teksti mësimor. Dallojnë përemrat pyetës dhe i shkruajnë.	

Nxënësit lexojnë me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor, dhe nëse kanë paqartësi, bëjnë pyetje për sqarime.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni një tekst dhe dalloni përemrat pyetës.

Grupi II - Krijoni 5 fjali me përemra pyetës dhe dalloni rasën.

Grupi III - Krijoni 4 fjali dhe nënvizoni përemrat pyetës.

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni përemrat pyetës, dalloni gjininë dhe rasën.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor në fletoren shkollore.

Mësimdhënësi sqaron detyrat duke u ndalur te ato më të vështirat.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura gjatë orës.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni përemrin pyetës.

Vërejtjet e mësimeve për realizimin: _____

Planifikim ditor 8

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Përemri lidhor.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, televizori etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: rasë, gjini, përemër etj.

Arritjet e të nxënësve:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë dhe sqarojë disa lloje të përemrit;
- përemrat lidhorë;

Veprimtaritë e nxënësve:

- përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- identifikojnë përemrin lidhor;
- dallojnë në tabelë përemrat lidhorë përmes rrjetit të diskutimit;
- lexojnë fjalitë nga libri i nxënësve;
- në grupe punojnë detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor

Veprimtaritë e mësuesit:

- fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- shpjegon përemrin lidhor;
- fton nxënësit përmes rrjetit të diskutimit të dallojnë përemrat lidhorë;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Stuhi mendimesh/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi paraqet në televizor pyetjet e përgatitura me power point.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve me ndihmën e mësimdhënësit.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Përemri lidhorë. Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor. Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përemra lidhorë quhen ato fjale që shërbejnë për të lidhur dy fjali, duke zënë vendin e një emri apo përemri të përmendur më parë.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po

Jo

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Mësimdhënësi shkruan në tabelë shembuj të ndryshëm dhe fton nxënësit të gjejnë përemrat lidhorë.

Nxënësit diskutojnë rreth shembujve të shkruar në tabelë.

Fton nxënësit të dallojnë përemrat pyetës në fjalitë e dhëna në tekstin mësimor, dhe të tregojnë me ç'rol përdoren.

Nxënësit shikojnë me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor dhe bëjnë pyetje sipas nevojës.

Hapi III – Punë në grupe

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 3 fjali me përemra lidhorë.

Grupi II - Krijoni një tekst dhe dalloni përemrat lidhorë.

Grupi III - Krijoni 4 fjali dhe nënvizoni përemrat lidhorë.

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni përemrat lidhorë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve. Fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani 7 fjali dhe nënvizo përemrat lidhorë.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 9

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Përemri i pacaktuar.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, televizori, etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, druri i problemit;

Fjalët kyçe: frymor, sende, pacaktuar, etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë dhe sqarojë disa lloje të përemrit;
- përemrat e pacaktuar;

Veprimtaritë e nxënësve:

- përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- identifikojnë përemrin e pacaktuar;
- lexojnë tekstin nga teksti mësimor;
- punojnë me metodën druri i problemit;
- në grupe punojnë detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- shpjegon përemrin e pacaktuar ;
- fton nxënësit të lexojnë nga teksti mësimor;
- nxit nxënësit përmes pyetjeve të punojnë me metodën druri i problemit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – Stuhi mendimesh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi paraqet pyetjet e përgatitura me power point dhe fton nxënësit të përgjigjen.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve me ndihmën e mësimdhënësit.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Përemri i pacaktuar


Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit
Shpjegon:

Përemra të
pacaktuar janë
ato përemra që tregojnë
frymorë a sende në mënyrë
të pacaktuar ose sasi të
pacaktuar të tyre.

Përemra të pacaktuar janë: kush,
dikush, ndonjë, askush, asgjë, çdo,
shumë, pak, gjithsecili, kushdo, cilido,
gjithë, mbarë, tërë, gjithfarë, gjithfarëlloj
etj.

Hapi II - Druri i problemit



Nxënësit lexojnë tekstin nga libri i nxënësit dhe dallojnë përemrat e pacaktuar.

Pas leximit të tekstit mësimdhënësi vizaton drurin e problemit në tabelë. Fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë drurin e problemit.

Dëgjon nxënësit për shpjegimet e bëra.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 3 fjali me përemra të pacaktuar kush, dikush.

Grupi II - Krijoni një tekst dhe dalloni përemrat e pacaktuar.

Grupi III - Krijoni 4 fjali dhe nënvizoni përemrat e pacaktuar shumë, pak.

Grupi IV - Krijoni 5 fjali me përemrat e pacaktuar kushdo, cilido, mbarë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve. Fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat në fletore dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Së bashku me nxënës arrihet në përfundim për përemrin e pacaktuar.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani 7 fjali dhe nënvizoni përemrat e pacaktuar.

Vërejtjet e mësimeve për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë përemrin;
- përkufizojnë llojet e përemrave.

Niveli i mesëm

- dallojnë përemrin;
- dallojnë përemrat vetvetorë, dëftorë, pronorë, lidhorë, pyetës, të pacaktuar.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali me përemra;
- krijojnë fjali me lloje të ndryshme të përemrave.

Aktivitetet e mësimit

- në tekst vërejnë përemrat;
- në tekst vërejnë përemrat vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë, të pacaktuar;
- ushtrojnë llojet e përemrave (vetvetorë, pronor, dëftor, lidhor, pyetës, të pacaktuar)
- komentojnë për llojet e përemrave;
- dallojnë dhe krijojnë fjali duke kombinuar përdorimin e tyre.

Detyrat për të kontrolluar

- Detyra plotësuese;
- Detyra saktë/pasaktë;
- Detyra rutinë (pyetje përgjigje)
- Detyra nga libri;
- Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 10

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Lajmi.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, televizori, etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh; INSERT, kubimi;

Fjalët kyçe: aktual, publik etj.

Arritjet e të nxënësve:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë tekste publicistike;
- të dëgjojë, shikojë tekste të rëndomta gojore joletrare (të lexuara, të incizuara, të ekranizuara);

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me teknikën INSERT;
- identifikojnë lajmin;
- punojnë me teknikën e kubimit;
- punojnë në çifte dhe në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësuesit:

- fton nxënësit të punojnë me teknikën INSERT;
- shpjegon lajmin;
- fton nxënësit të punojnë me teknikën e kubimit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I- INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi lëshon një lajm në televizor dhe pyet nxënësit? Bën sqarime për pyetjet dhe çështjet e ngritura nga nxënësit. Bëhet edhe plotësimi i mëtejshëm i tabelës së INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga ato që din ose mendon se i di.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Lajmi

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.


Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit. Lajmet janë njoftime për ngjarje të rëndësishme të ditës, që jepen nga agjencitë telegrafike, gazetatat, radioja apo televizioni.

Lajmi duhet të përmbushë tri kritere →

1. Të jetë me interes publik
2. Të jetë faktual
3. Të jetë i verifikuar dhe i verifikueshëm.

Nxënësit shikojnë me kujdes tekstin mësimor se si ndërtohet një lajm duke kaluar nëpër disa etapa. Mësimdhënësi shpjegon se para se të publikohet lajmi duhet të redaktohet, duke hequr pjesët e tepërta, veçanërisht në fundin e tekstit. Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve.

Hapi II - Teknika e kubimit / Punë në çifte



Mësimdhënësi paraqet temën (Lajmi)

Mësimdhënësi në të gjitha faqet e kubit ka shkruar një kërkesë dhenxit nxënësit të përgjigjen pyetjeve.

Nxënësit shkëmbejnë përgjigjet për secilën faqe të kubit.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjithë grupet shkruajnë një lajm që e kanë shikuar në televizor.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Pyetje:

1. Çfarë është lajmi?
2. Cili është synimi dhe funksioni i lajmeve ?
3. Si duhet të jetë lajmi?
4. Cilat janë disa nga veçoritë e ndërtimit të lajmit?
5. Cilat janë kriteret që duhet të përmbushë një lajm?
6. Cilat janë etapat në të cilat kalon ndërtimi i një lajmi?

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat. Mësimdhënësi kontrollon dhe vlerëson.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një lajm.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë lajmin;
- përkufizojnë kriteret e ndërtimit të lajmit;
- emërtojnë etapat e ndërtimit të lajmit.

Niveli i mesëm

- dallojnë lajmin;
- dallojnë kriteret e ndërtimit të lajmit;
- dallojnë etapat e ndërtimit të lajmit.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë një lajm;
- krijojnë një lajm duke u bazuar në kriteret e lajmit;
- krijojnë një lajm duke u bazuar në etapat e ndërtimit të lajmit.

Aktivitetet e mësimit

- ushtrojnë llojet e lajmeve;
- komentojnë për kriteret dhe etapat e ndërtimit të lajmeve;
- dallojnë dhe krijojnë lajme sipas kriterëve.

Detyrat për të kontrolluar

- Detyra plotësuese;
- Detyra saktë/pasaktë;
- Detyra rutinë (pyetje përgjigje)
- Detyra nga libri;
- Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 11

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, INSERT, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: kam, jam etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë:
- të njohë foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me teknikën INSERT;
- lexojnë pjesën nga libri i nxënësit;
- identifikojnë foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor

Veprimtaritë e mësuesit/es:

- fton nxënësit të punojnë me teknikën INSERT;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor dhe të gjejnë foljet *kam* dhe *jam*;
- shpjegon foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë pjesën nga libri dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat.

Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga ato që din ose mendon se i din.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Folje ndihmëse janë ato folje të cilat shërbejnë për të formuar kohët e përbëra.

Si folje gjysmëndihmëse në gjuhën shqipe merren:

1. folja këpujore;
2. foljet me vlerë modale;
3. foljet që shprehin mënyrën e veprimit.

Foljet gjysmëndihmëse janë pjesë përbërëse e një togu kallëzuesor, duke i dhënë atij disa nuanca kuptimore.

Si folje ndihmëse në gjuhën shqipe merren foljet *kam* dhe *jam*.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po _____ Jo _____

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Fton nxënësit të punojnë me teknikën rrjeti i diskutimit.

Mësimdhënësi shkruan shembuj të ndryshëm në tabelë dhe fton nxënësit të gjejnë foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe diskutojnë rreth shembujve të shkruar në tabelë.

Hapi III- Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Formoni nga 4 fjali ku foljet *kam* dhe *jam* të përdoren me kuptim të plotë leksikor.

Grupi II – Formoni 4 fjali ku foljet *kam* dhe *jam* të përdoren si folje ndihmëse

Grupi III – Formoni 4 fjali ku foljet *kam* dhe *jam* të përdoren si folje gjysmëndihmëse;

Grupi IV - Foljen mund të përdorni në fjali herë si folje gjysmëndihmëse dhe herë si folje me kuptim të plotë leksikor.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II- Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësuesin/en.

Mësimdhënësi kontrollon dhe vlerëson.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Formoni 4 fjali ku foljet *kam* dhe *jam* të përdoren si folje ndihmëse dhe

gjysmëndihmëse.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 12

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Mënyra dëftore dhe habitore.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, etj;

Metodat dhe teknikat e realizimit: pema e mendimit, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: dëftore, habitore etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:
- të dallojë mënyrat e foljes;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën pema e mendimit;
- identifikojnë mënyrat dëftore dhe habitore;
- lexojnë pjesën nga libri i nxënësit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë pemën e mendimit;
- shpjegon mënyrën dëftore dhe habitore;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën dhe të dallojnë mënyrën dëftore dhe habitore;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit


Evokim

Hapi I - Pema e mendimit/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi në mes të tabelës shkruan Mënyrat e foljes dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit dhe kujtojnë mënyrat e foljes.




Realizim kuptimi

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Mënyra dëftore dhe habitore.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.



Hapi II - Stuhi mendimesh

Nxënësit lexojnë pjesën nga teksti mësimor dhe provojnë të zgjedhjnë foljet me shkrim të pjerrët, duke kujtuar kategoritë gramatikore të foljes.

Mësimdhënësi vazhdon të sqaroj përmes pyetjeve dhe përgjigjeve.

Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve për të vështuar dhe analizuar shembujt e dhënë.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 4 fjali duke përdorur foljet në mënyrën dëftore;

Grupi II - Krijoni 4 fjali duke përdorur foljet në mënyrën habitore;

Grupi III - Krijoni një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën dëftore;

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën habitore.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ush-

trimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime rreth pyetjeve.

Detyrë shtëpie: Krijoni një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën dëftore dhe habitore.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 13

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Mënyra lidhore dhe kushtore.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj;

Metodat dhe teknikat e realizimit: INSERT, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: lidhore, kushtore etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:
- të dallojë mënyrat e foljes;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën e INSERTIT;
- lexojnë fragmentin nga teksti mësimor;
- identifikojnë mënyrat lidhore dhe kushtore;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë fragmentin nga teksti mësimor dhe të dallojnë mënyrën lidhore dhe kushtore;
- shpjegon mënyrën lidhore dhe kushtore;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – INSERT/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë fragmentin nga teksti mësimor dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat. Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër shkruhen në tabelë e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.


Realizim kuptimi

Hapi I – Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Mënyra lidhore dhe kushtore.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit



Hapi II - Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi shkruan shembuj të ndryshëm në tabelë dhe fton nxënësit t'i punojnë.

Duke bashkëbiseduar me nxënësit, i fton ata në mënyrë individuale të shikojnë ushtrimet.

Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime rreth pyetjeve.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 4 fjali duke përdorur foljet në mënyrën kushtore;

Grupi II - Krijoni 4 fjali duke përdorur foljet në mënyrën lidhore;

Grupi III - Krijoni një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën kushtore;

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën lidhore;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Diskutohet me nxënësit se si u janë përgjigjur kërkesave.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën..

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën lidhore dhe kushtore.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 14

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Mënyra dëshirore dhe urdhërore.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: di, dua të di, mësova, stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: dëshirore, urdhërore etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:
- të dallojë mënyrat e foljes;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë mënyrat dëftore dhe habitore;
- lexojnë fjalitë nga teksti mësimor;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon mënyrën dëshirore dhe urdhërore;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor dhe të dallojnë mënyrën dëshirore dhe urdhërore;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Mënyra dëshirore dhe urdhërore.	Mënyrën dëftore, kushtore, lidhore, habitore.	Për mënyrën dëshirore dhe urdhërore.	

Nxënësit plotësojnë tabelën di, dua të di, kurse mësova në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi

Hapi I- Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Mënyra dëshirore dhe urdhërore
Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Në mënyrën dëshirore veprimi i shprehur nga folja paraqitet si një dëshirë në formën e një urimi ose mallkimi.

Në mënyrën urdhërore veprimi i shprehur nga folja shpreh një urdhër, kërkesë apo këshillë.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po

Jo

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Nxënësit lexojnë me vëmendje pjesën nga teksti mësimor dhe provojnë të gjejnë foljet në mënyrën dëshirore dhe urdhërore.

Mësimdhënësi shkruan në tabelë disa shembuj.

Nxënësit i punojnë në fletore dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi fton nxënësit në mënyrë individuale të vështrojnë ushtrimet nga libri i nxënësit, duke bashkëbiseduar me nxënësit dhe duke i lënë ata të gjykojnë.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 4 fjali duke përdorur foljet në mënyrën dëshirore;

Grupi II - Krijoni 4 fjali duke përdorur foljet në mënyrën urdhërore;

Grupi III - Krijoni një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën dëshirore;

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën urdhërore.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I- Veprimtari me tekstin mësimor

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ushtrime.

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Hapi II- Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve të dhëna.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të tyre dhe për pjesëmarrjen në orën mësimore.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni foljet në mënyrën dëshirore dhe urdhërore.

Vërejtjet e mësuesit/es për realizimin: _____

Planifikim ditor 15

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Zgjedhimi jovepror i foljeve.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.;

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh; INSERT;

Fjalët kyçe: vepror, mesor, vetvetor etj.

Arritjet e të nxënës:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë:
- diatezat e foljes;

Veprimtaritë e nxënësit/es:

- zbatojnë metodën INSERT;
- lexojnë pjesën përkatëse nga libri;
- identifikojnë foljet njëvetore dhe pavetore;
- bashkëpunojnë në grupe për të punuar detyrat e dhëna;
- në fletore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;

Veprimtaritë e mësuesve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë tekstin dhe të shikojnë tabelat e zgjedhimit;
- shpjegon diatezat e foljes;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë tekstin nga libri i nxënësit dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat. Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Zgjedhimi jovepror i foljeve

Që nxënësi të punojë si duhet i orienton si të punojnë me librin: të lexojnë tekstet, të analizojnë shembujt dhe të punojnë me kujdes.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përveç formave të zgjedhimit vepror, në gjuhën shqipe ka edhe forma të zgjedhimit jovepror.

Folja në gjuhën shqipe ka katër diateza:

vepror, mësor, pësor
dhe vetvetor

Hapi II - Stuhi mendimesh

Fton nxënësit të vështrojnë tabelat e zgjedhimeve nga teksti mësimor.

Nxënësit shikojnë me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor dhe bëjnë pyetje ku është e nevojshme.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 5 fjali më folje në formën jovepror.

Grupi II - Foljen fsheh e zgjedhoni në të gjitha kohët e mënyrës dëftore, në formën jovepror

Grupi III - Krijoni 4 fjali më folje në formën jovepror.

Grupi IV – Foljen forcoj e zgjedhoni në të gjitha kohët e mënyrës dëftore, në formën jovepror.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime rreth pyetjeve.

Në bashkëbisedim me nxënësit nxirren përfundimet.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të tyre dhe për pjesëmarrjen në orën mësimore.

Detyrë shtëpie: Shkruani 8 fjali me folje në formën jovepror.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 16

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Foljet njëvetore dhe pavetore.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh; INSERT;

Fjalët kyçe: njëvetore, pavetore etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë:
- të dallojë foljet njëvetore dhe foljet pavetore;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën INSERT;
- lexojnë pjesën nga libri i nxënësit;
- identifikojnë foljet njëvetore dhe pavetore;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga libri i nxënësit;
- shpjegon foljet njëvetore dhe pavetore;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme;

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë pjesën nga libri i nxënësit dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat. Nën-vizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri /Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Foljet njëvetore dhe pavetore

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit:

Shumica e foljeve përdoren në të tri vetat, në njëjës e në shumës. Por ka edhe disa folje të cilat përdoren vetëm në vetën e tretë.

Ato ndahen në dy grupe:

- a. folje njëvetore
- b. folje pavetore

Hapi II – Stuhi mendimesh

Fton nxënësit shikojnë me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor dhe bëjnë pyetje sipas nevojës. Mësimdhënësi vazhdon të sqarojë përmes pyetjeve dhe përgjigjeve. Gjatë gjithë kohës së bashkëbisedimit mësimdhënësi nxit dhe aktivizon nxënësit.

Hapi III – Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 5 fjali më folje njëvetore;

Grupi II - Krijoni një tekst duke përdorur folje njëvetore dhe pavetore;

Grupi III - Krijoni 4 fjali më folje pavetore;

Grupi IV - Krijoni një tekst duke përdorur folje njëvetore dhe pavetore;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve. Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor. Diskutohet rreth kërkesave të ushtrimeve.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani 8 fjali me folje njëvetore dhe pavetore.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 17

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Klasifikimi i foljeve në zgjedhime.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari dypjesësh, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: zgjedhim etj.

Arritjet e të nxënit:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë zgjedhimet e foljes:
- zgjedhimi i parë;
- zgjedhimi i dytë;
- zgjedhimi i tretë;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me ditarin dypjesësh;
- identifikojnë zgjedhimin I, II, III;
- lexojnë tekstin nga libri i nxënësit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin dypjesësh;
- shpjegon zgjedhimin I, II, III;
- fton nxënësit të lexojnë tekstin nga libri i nxënësit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi i parë - Ditari dypjesësh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin dypjesësh. Shkruan pyetjen dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Pyetja	Zgjedhimi
Gjeni foljet në fjalitë në tekstin mësimor dhe përpikuni t'i gruponi në zgjedhime.	I II III

Nxënësit plotësojnë ditarin dy pjesësh me ndihmën e mësimehdhënesit. Realizim kuptimi

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Klasifikimi i foljeve në zgjedhime.

Që nxënësi të punojë si duhet i orienton si të punojnë me librin: të lexojnë tekstet, të analizojnë shembujt dhe të punojnë me kujdes.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimehdhënesit.

Sipas temës me të cilën dalin dhe mbaresave që marrin në kohën e tashme të mënyrës dëftore, foljet klasifikohen në tri zgjedhime kryesore:



Përveç foljeve që klasifikohen në zgjedhime, ka edhe një numër foljesh të cilat në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore dalin me temë krejt të ndryshme nga ajo e kohës së tashme. Këto quhen folje të parregullta.

Hapi II – Stuhi mendimesh

Nxënësit shikojnë me kujdes tabelat e zgjedhimeve nga teksti mësimor dhe bëjnë pyetje sipas nevojës. Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime rreth pyetjeve

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën. Të gjitha grupet shkruajnë një tekst dhe i klasifikojnë foljet në zgjedhime.

Zgjedhimi I	Zgjedhimi II	Zgjedhimi III

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Ndjek me vëmendje aktivizimin e nxënësve, si në punën me grupe, edhe në reflektim.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe klasifikoni foljet në zgjedhime.

Vërejtjet e mësuesit/es për realizimin: _____

Planifikim ditor 18

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Format e pashtjelluara të foljes.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari trepjesësh, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: pjesore, paskajore, mohore, përcjellore etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë:
- të njohë dhe të dallojë format e pashtjelluara të foljes

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me ditarin trepjesësh;
- identifikojnë format e pashtjelluar të foljes;
- lexojnë pjesën nga libri i nxënësit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësuesve:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin trepjesësh;
- shpjegon format e pashtjelluara;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga libri i nxënësit dhe të dallojnë format e pashtjelluara;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Ditari trepjesësh/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin trepjesësh. Shkruan pyetjen dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Detyra	Format e pashtjelluara të foljes	Komenti i mësimdhënësit
Lexoni pjesën nga teksti mësimor dhe gjeni format e pashtjelluara.	pjesore paskajore përcjellore mohore	

Nxënësit plotësojnë ditarin trepjesësh me ndihmën e mësimeve.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimeve shkruan titullin në tabelë: Format e pashtjelluara të foljes

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimeve.

Format e pashtjelluara të foljes janë:

pjesore (lexuar)	paskajore (për të lexuar)	përcjellore (duke lexuar)	mohore (pa lexuar)
---------------------	------------------------------	------------------------------	-----------------------

Hapi II – Stuhi mendimesh

Mësimeve shkruan në tabelë disa ushtrime dhe fton nxënësit t'i punojnë. Nxënësit i punojnë detyrat e dhëna.

Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime rreth detyrave

Hapi III - Punë në grupe

Mësimeve i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjitha grupet shkruajnë një tekst dhe i paraqesin në tabelë format e pashtjelluara

pjesore	paskajore	përcjellore	mohore

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimeve.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimeve i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes dhe i komentojnë me mësimeve.

Mësimeve i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Ndjek me vëmendje aktivizimin e nxënësve, si në punën me grupe, edhe në reflektim

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një lajmërim publik.

Vërejtjet e mësuesit/es për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë foljen;
- përkufizojnë foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse;
- emërtojnë mënyrat e foljes;
- përkufizojnë diatezat e foljes;
- emërtojnë foljet njëvetore;
- përkufizojnë format e pashtjelluar të foljes.

Niveli i mesëm

- dallojnë foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse;
- dallojnë mënyrat e foljes;
- dallojnë diatezat e foljes;
- dallojnë foljet njëvetore;
- dallojnë zgjedhimin e foljes;
- dallojnë format e pashtjelluara të foljes

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali me foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse;
- krijojnë fjali me mënyrat e foljes;
- krijojnë fjali me format e pashtjelluara të folje

Aktivitetet e mësimit

- ushtrojnë mënyrat e foljes;
- komentojnë për foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse;
- komentojnë për zgjedhimin e foljeve;
- dallojnë dhe krijojnë fjali me format e pashtjelluara

Detyrat për të kontrolluar

- Detyra plotësuese;
- Detyra saktë/pasaktë;
- Detyra rutinë (pyetje përgjigje)
- Detyra nga teksti mësimor;
- Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve

Planifikim ditor 19

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Lajmërimi publik.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.;

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh; di dua të di, mësova, kubimi;

Fjalët kyçe: lajmërim, informacion, njoftim, etj.

Arritjet e të nxënit:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:
- të dëgjojë, shikojë tekste të rëndomta gojore jolettrare (të lexuara, të incizuara, të ekranizuara)

Veprimtaritë e nxënit:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë lajmërimin publik;
- lexojnë lajmërimet nga teksti mësimor;
- punojnë me teknikën e kubimit në çifte;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon lajmërimin publik;
- fton nxënësit të lexojnë lajmërimin nga teksti mësimor;
- fton nxënësit të punojnë me teknikën e kubimit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Lajmërimi publik	Për lajmërimin.	Për lajmërimin publik.	

Nxënësit plotësojnë tabelën di, dua të di, kurse mësova në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Lajmërimi publik

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.


Lajmërimi publik është një deklaratë zyrtare që i bëhet e njohur publikut të gjerë.

Lajmërimi publike janë:

Deklaratat e qeverisë për ndryshimet në legjislacion.
Lajmërimi për evente të rëndësishme, si festivale apo takime publike.
Njoftime për rreziqe shëndetësore ose emergjenca.
Informacion për ndryshime në shërbimet publike etj.

Nxënësit shikojnë me kujdes llojet e lajmërimeve publike në tekstin mësimor dhe bëjnë pyetje sipas nevojës.

Hapi II – Teknika e kubimit/ Punë në çifte



Mësimdhënësi paraqet temën.(Lajmërimi publik)
Mësimdhënësi në të gjitha faqet e kubit shkruan një kërkesë dhe nxit nxënësit të përgjigjen pyetjeve.
Nxënësit shkëmbejnë përgjigjet për secilën faqe të kubit

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjithë grupet shkruajnë një lajmërim publik

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Pyetje:

1. Çështë një lajmërim publik?
2. Çfarë përmban një lajmërim publik?
3. Kush i përdor lajmërimet publike?
4. Përmendni disa lloje lajmërimesh publike.
5. Cilat janë hapat që duhet të ndjekim për hartimin e një lajmërimi publik?
6. Hartoni një lajmërim publik për konkursin e fjalës poetike që do të zhvillohet në shkollën tuaj.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një lajmërim publik.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë lajmërimin publik;
- emërtojnë hapat që duhet ndjekur për të krijuar një lajmërim publik;
- përkufizojnë llojet e lajmërimeve publike.

Niveli i mesëm

- dallojnë lajmërimin publik;
- dallojnë hapat që duhet ndjekur për të krijuar një lajmërim publik;
- dallojnë llojet e lajmërimeve publike.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë një lajmërim publik;
- krijojnë vetë një lajmërim publik duke ndjekur hapat e duhur.

Aktivitetet e mësimit

- në tekst vërejnë lajmërimin publik;
- ushtrojnë llojet e lajmërimeve publike;
- komentojnë për lajmërimet publike;
- krijojnë vetë lajmërimet publike.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga libri;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 20

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Ndajfolja.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: pema e mendimit, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: mënyre, sasi, kohë, vendi, shkaku etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë dhe kuptojë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës:

- ndajfoljen;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën pema e mendimit;
- identifikojnë ndajfoljen;
- identifikojnë shkallët e ndajfoljes;
- lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë së bashku pemën e mendimit;
- shpjegon ndajfoljen;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.


Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – Pema e mendimit/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi në mes të tabelës shkruan Fjalët e pandryshueshme dhe fton nxënësit të plotësojnë. Nxënësit me ndihmën e mësimit plotësojnë pemën e mendimit dhe kujtojnë fjalët e pandryshueshme.



Realizim kuptimi

Hapi I – informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Ndajfolja

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Ndajfolja shërben për të emërtuar një tipar të veprimit apo të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet një veprim ose për të treguar shkallën e një cilësie apo intensitetin e veprimit

Për nga ndërtimi ndajfoljet mund të jenë: të parme, të prejardhura, të përngjitura, shprehje ndajfoljore.

Ndahen në disa lloje: mënyre, sasi, kohë, vendi, shkaku.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po _____ Jo _____

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Nxënësit lexojnë me kujdes pjesën nga teksti mësimor dhe dallojnë ndajfoljet e ndryshme.

Mësimdhënësi shkruan disa ushtrime në tabelë dhe nxit nxënësit përmes pyetjeve t'i punojnë.

Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime rreth pyetjeve.

Mësimdhënësi vazhdon të shpjegojë se ndajfoljet përdoren në shkallë të ndryshme. Shkallët e ndajfoljes janë: pohore, krahasore dhe sipërore.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 3 fjali me ndajfolje mënyre;

Grupi II - Krijoni 5 fjali me ndajfolje shkaku;

Grupi III - Krijoni 4 fjali me ndajfolje vendi;

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni llojet e ndajfoljeve;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësim-

dhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna dallojnë ndajfoljet dhe tregojnë nëse janë fjalë të parme, të prejardhura, të përngjitura apo shprehje ndajfoljore.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit zëvendësojnë vendet e lëna bosh me ndajfoljet në kllapa: (aty, asgjëkundi, gjithmonë, menjëherë, aty afër, nxitimthi, fillimisht, sonte, gjatë, mbrëmë).

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në tekstin e dhënë gjejnë ndajfoljet dhe i vendosni në tabelë te libri i nxënësit.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna gjejnë ndajfoljet, tregojnë llojin dhe shkallën e tyre (nëse e kanë).

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi kontrollon dhe vlerëson.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për ndajfoljen.

Detyrë shtëpie: Formoni 4 fjali me llojet e ndajfoljeve.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë ndajfoljen;
- emërtojnë llojet e ndajfoljeve;
- përkufizojnë shkallët e ndajfoljeve.

Niveli i mesëm

- dallojnë ndajfoljet;
- dallojnë llojet e ndajfoljeve; ;
- dallojnë shkallët e ndajfoljeve.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali me ndajfolje;
- krijojnë vetë fjali me ndajfolje të ndryshme;
- krijojnë vetë fjali me ndajfolje në shkallën pohore, krahasore, sipërore.

Aktivitetet e mësimit

- në tekst vërejnë ndajfoljet;
- ushtrojnë llojet e ndajfoljeve
- komentojnë për shkallët e ndajfoljeve;
- krijojnë vetë fjali me llojet e ndajfoljeve.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje, përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 21

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Raporti.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari trepjesësh, stuhi mendimesh, teknika e kubimit;

Fjalët kyçe: përshkrim, plotësim etj.

Arritjet e të nxënit:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të hartojë tekste publicistike;
- raport mbi ngjarje interesante – aktuale;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me ditarin trepjesësh;
- identifikojnë raportin;
- lexojnë raportin nga teksti mësimor;
- punojnë në çifte me teknikën e kubimit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin trepjesësh;
- shpjegon raportin;
- fton nxënësit të lexojnë raportin nga teksti mësimor;
- fton nxënësit në çifte të punojnë me teknikën e kubimit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme;

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Ditari trepjesësh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin trepjesësh. Shkruan pyetjen dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Pyetja	Përgjigje	Komenti i mësimeve
Nxënësit përgjigjen pyetjeve të përgatitura për një ngjarje. Si duhet të shkruhet? Çfarë duhet të përmbajë?		

Nxënësit plotësojnë ditarin trepjesësh me ndihmën e mësimeve.

Reflektim

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimeve shkruan titullin në tabelë: Raporti


Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimeve.

Raporti është kumtim apo parashtesë me shkrim, që i bëhet një organi më të lartë, duke përshkruar, analizuar ose raportuar për një situatë të caktuar, një ngjarje, një projekt, një çështje, për plotësimin e një detyre ose për gjendjen e një pune.

Nxënësit lexojnë raportin nga teksti mësimor.

Hapi II- Teknika e kubimit/ Punë në çifte



Mësimeve paraqet temën. (Raporti)

Mësimeve në të gjitha faqet e kubit ka shkruar një kërkesë në bazë të elementeve të raportit dhe nxit nxënësit të përgjigjen pyetjeve.

Nxënësit shkëmbejnë përgjigjet për secilën faqe të kubit.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimeve i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjitha grupet shkruajnë një raport duke u bazuar te elementet.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimeve.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve. Mësimeve i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Pyetje:

1. Ç'është raporti?
2. Cilat janë elementet e raportit?
3. Cilat janë disa tipare të raportit?
4. Me se mund të jetë i shoqëruar një raport?

5. Ku përdoren raportet dhe cili është qëllimi i tyre?
6. Cilat janë disa lloje të raporteve?
7. Hartoni një raport me temë *“Aktivitetet sportive në shkollën tonë”*.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një raport.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë raportin;
- emërtojnë elementet e raportit;
- përkufizojnë llojet e raporteve.

Niveli i mesëm

- dallojnë raportin;
- dallojnë elementet e raporteve; ;
- dallojnë llojet e raporteve.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë një raport;
- krijojnë vetë një raport duke u nisur nga elementet;
- krijojnë raporte të ndryshme.

Aktivitetet e mësimit

- në tekstin mësimor lexojnë raportin;
- ushtrojnë llojet e raporteve;
- komentojnë për elementet e raportit;
- krijojnë vetë një raport.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 22

Libër mësuesi

Lënda: gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Parafjala.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.;

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, INSERT;

Fjalët kyçe: të thjeshta, të përngjitura etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë dhe kuptojë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës:

- parafjalën;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën INSERT;
- lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- identifikojnë parafjalën;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- shpjegon parafjalën;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë pjesën nga libri i nxënësit dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat. Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

$\sqrt{\quad}$	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I- Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Parafjala.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Parafjalë quhet ajo klasë fjalësh të pandryshueshme që vihet para një emri, një përemri apo një numërori të një rase të caktuar dhe që shërben për t'i lidhur ata me fjalë të tjera në fjali.

Sipas ndërtimit, parafjalët mund të jenë:

- të thjeshta
- të përngjitura
- shprehje parafjalore

Hapi II – Stuhi mendimesh

Fton nxënësit të lexojnë në heshtje pjesën dhe të mundohen të gjejnë parafjalët.

Nxënësit shikojnë me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor dhe bëjnë pyetje sipas nevojës.

Mësimdhënësi shkruan disa fjali në tabelë dhe nxit nxënësit të gjejnë parafjalët.

Nxënësit aktivizohen duke punuar shembuj të ndryshëm dhe diskutojnë me mësimdhënësin.

Hapi III – Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Formoni 4 fjali me parafjalë që të jenë fjalë të parme;

Grupi II - Shkruani një tekst dhe nënvizoni parafjalët;

Grupi III - Formoni 5 fjali me parafjalë të përngjitura;

Grupi IV - Formoni 6 fjali me parafjalë që të jenë fjalë të parme dhe të përngjitura;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna nënvizoni parafjalët.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit plotësojnë vendet e lëna bosh me parafjalët e duhura.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë parafjalët dhe i klasifikojnë sipas ndërtimit.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë parafralët dhe thonë me ç'rasë janë përdorur.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi kontrollon dhe vlerëson.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për parafralën.

Detyrë shtëpie: Formoni 4 fjali me parafralë që të jenë fjale të përngjitura.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë parafjalën;
- emërtojnë llojet e parafjalëve;
- përkufizojnë rasat që përdorën parafjalët.

Niveli i mesëm

- dallojnë parafjalën;
- dallojnë llojet e parafjalëve;
- dallojnë rasat që përdoren parafjalët.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali me parafjalë;
- krijojnë vetë fjali me llojet e parafjalëve;
- krijojnë fjali me parafjalë në rasa të ndryshme.

Aktivitetet e mësimit

- lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- ushtrojnë llojet e parafjalëve;
- komentojnë për llojet e parafjalëve;
- krijojnë vetë fjali dhe nënvizojnë parafjalët.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 23

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Lidhëza. Lidhëza bashkërenditëse.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari trepjesësh, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: shtuese, veçuese, përmbyllëse etj.

Arritjet e të nxëniet:

Gjatë mësimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë dhe kuptojë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës:

- lidhëzën ;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me ditarin trepjesësh;
- identifikojnë lidhëzat bashkërenditëse;
- lexojnë tekstin nga libri i nxënësit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin trepjesësh;
- shpjegon lidhëzën. Lidhëza bashkërenditëse.
- fton nxënësit të lexojnë nga teksti mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Ditari trepjesësh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin trepjesësh.

Shkruan pyetjen dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Pyetja	Përgjigjja	Komenti i mësimit
Në tekstin e dhënë të libri i nxënësit mundoheni të gjeni lidhëzat.		

Nxënësit plotësojnë ditarin trepjesësh me ndihmën e mësimeve.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë : Lidhëza. Lidhëza bashkërenditëse.

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dh dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Lidhëza është ajo klasë fjalësh e pandryshueshme që shërben për të lidhur dy gjymtyrë fjalie ose dy pjesë të një fjalie të përbërë.

Sipas strukturës lidhëzat i kemi: të thjeshta, të përngjitura dhe lokucione.

Sipas rolit që luajnë lidhëzat ndahen në dy grupe të mëdha: bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

Sipas kuptimit që kanë lidhëzat bashkërenditëse ndahen në:

veçuese

kundërshtore

përmbyllëse

të shkallëzimit

shtuese ose
këpujore

Hapi II - Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi shkruan fjali të ndryshme në tabelë dhe fton nxënësit të gjejnë llojet e lidhëzave.

Nxënësit punojnë detyrat e dhëna dhe bëjnë pyetjeve sipas nevojës.

Mësimdhënësi vazhdon të sqarojë sipas nevojës.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 2 fjali me lidhëzat bashkërenditëse shtuese;

Grupi II - Krijoni 2 fjali me lidhëzat bashkërenditëse veçuese;

Grupi III - Krijoni 2 fjali me lidhëzat bashkërenditëse përmbyllëse;

Grupi IV - Krijoni 2 fjali me lidhëzat bashkërenditëse kundërshtuese;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbejnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna gjejnë lidhëzat dhe thonë çfarë lidhin.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë lidhëzat dhe i vendosni në tabelë.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna dallojnë lidhëzat bashkërenditëse dhe

thonë llojin e tyre.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në vendet e lëna bosh shkruajnë lidhëzën që mungon. Tregojnë llojin e saj.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes ushtrimet dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni lidhëzat bashkërenditëse.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 24

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Lidhëza nënrenditëse.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj;

Metodat dhe teknikat e realizimit: di, dua të di, mësova, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: dëshirore, urdhërore etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimin nxënësi do jetë në gjendje të njohë dhe kuptojë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës:

- lidhëzën nënrenditëse;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë lidhëzat nënrenditëse;
- lexojnë fjalitë nga libri i nxënësit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon lidhëzat nënrenditëse;
- fton nxënësit të lexojnë fjalitë nga teksti mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimin

Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë.

Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Lidhëza nënrenditëse	Lidhëzat bashkërenditëse	Për lidhëzat nënrenditëse	

Nxënësit plotësojnë tabelën di, dua të di, kurse mësova në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi

Hapi I- Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë : Lidhëzat nënrenditëse

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Lidhëzat nënrenditëse shërbejnë për të lidhur dy pjesë të fjalisë së përbërë (një fjali të varur me fjalinë drejtuese të saj). Pra ato shprehin raporte varësie.

Ndahen në: ffilluese, qëllimore, shkakore, kohore, vendore, krahasore-mënyrore, kushtore, lejore, rrjedhimore, kundërvënëse.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Fton nxënësit të lexojnë me kujdes tekstin e dhënë nga libri i nxënësit dhe të gjejnë lidhëzat nënrenditëse.

Mësimdhënësi vazhdon të sqaroj përmes pyetjeve dhe përgjigjeve

Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve për të vështuar dhe analizuar me shembujt e dhënë.

Bëjnë pyetje, diskutime, plotësime.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 4 fjali me lidhëzat vendore dhe kohore;

Grupi II - Krijoni 4 fjali me lidhëzat ffilluese dhe qëllimore;

Grupi III - Krijoni 4 fjali me lidhëzat shkakore dhe kushtore;

Grupi IV - Krijoni 4 fjali me lidhëzat lejore dhe rrjedhimore;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë lidhëzat dhe tregojnë cilat janë bashkërenditëse dhe cilat janë nënrenditëse.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit dallojnë lidhëzat nënrenditëse dhe thonë llojin e tyre.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit tregojnë llojin e lidhëzave me shkronja të zeza.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit formojnë nga një fjali me lidhëza nënrenditëse sipas llojeve.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve të dhëna.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani 5 fjali me lidhëzat nënrenditëse.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- përkufizojnë lidhëzat;
- emërtojnë lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse
- përkufizojnë llojet e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

Niveli i mesëm

- dallojnë lidhëzat;
- dallojnë lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse;
- dallojnë llojet e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali me llojet e lidhëzave bashkërenditëse;
- krijojnë vetë fjali me llojet e lidhëzave nënrenditëse.

Aktivitetet e mësimit

- lexojnë shembuj nga teksti mësimor;
- ushtrojnë llojet e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse;
- komentojnë për llojet e lidhëzave;
- krijojnë vetë fjali me lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga libri;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 25

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Biografia.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari trepjesësh, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: përshkrim, person etj.

Arritjet e të nxënit:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë:
- përshkrimin e jetës së një personaliteti të njohur (biografia e një shkrimtari, piktori, kompozitori, sportisti);

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me ditarin trepjesësh;
- identifikojnë biografinë;
- identifikojnë autobiografinë
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin trepjesësh;
- shpjegon biografinë;
- fton nxënësit të lexojnë një biografi;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Ditari trepjesësh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin trepjesësh.

Shkruan pyetjen dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Pyetja	Përgjigje	Komenti i mësimeve
Nxënësit përgjigjen pyetjeve të përgatitura për një biografi të një shkrimtari.		

Nxënësit plotësojnë ditarin trepjesësh me ndihmën e mësimeve.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri / Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Biografia

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Biografia është një lloj shkrimi që përshkruan dhe dokumenton jetën e një personi. Ajo përshkruan ngjarjet kyçe, përvojat dhe kontributet e një individi nga lindja deri në momentin kur shkruhet.

Kur biografia shkruhet nga vetë personi atëherë ajo quhet autobiografi.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po

Jo

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Mësimdhënësi lexon një biografi dhe parashtron pyetjet.

Përmes rrjetit të diskutimit nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me bografinë e lexuar.

Mësimdhënësi vazhdon të sqaroj përmes pyetjeve dhe përgjigjeve.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjitha grupet shkruajnë një biografi.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Pyetje:

1. Ç'është biografia?
2. Ç'është autobiografia?
3. Për çfarë shërben biografia?
4. Cilat janë qëllimet e hartimit të biografisë?
5. Cilat janë elementet themelore të biografisë?
6. Gjeni shembuj biografish të shkruara për njerëz të shquar.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një biografi.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- përkufizojnë biografinë;
- emërtojnë autobiografinë.

Niveli i mesëm

- dallojnë biografinë;
- dallojnë autobiografinë; ;
- dallojnë elementet themelore të biografisë.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë biografi;
- krijojnë biografinë e ndonjë personaliteti të njohur;
- krijojnë biografi të ndryshme.

Aktivitetet e mësimit

- komentojnë për çfarë shërben biografia;
- komentojnë qëllimet e biografisë;
- komentojnë elementet themelore të biografisë;
- krijojnë biografi të ndryshme.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 26

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Pjesëza.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, etj.;

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, INSERT, druri i problemit;

Fjalët kyçe: të thjeshta, të përngjitura etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë dhe kuptojë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës:

- pjesëzën;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën INSERT;
- lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- identifikojnë pjesëzën;
- punojnë me metodën druri i problemit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësuesit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- shpjegon pjesëzën;
- fton nxënësit të punojnë me metodën druri i problemit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I – INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë pjesën nga libri i nxënësit dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat.

Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Pjesëza.

Që nxënësi të punojë si duhet i orienton si të punojnë me librin: të lexojnë tekstet, të analizojnë shembujt dhe të punojnë me kujdes.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Pjesëza është ajo klasë e pandryshueshme fjalësh që shërben për të bërë plotësime në kuptimin e një fjale apo të një fjalie, që pohon ose mohon një mendim.

Sipas ndërtimit pjesëzat janë:

- të thjeshta
- të përngjitura
- shprehje

Hapi II - Druri i problemit



Nxënësit lexojnë fjalitë nga teksti mësimor.

Mësimdhënësi vizaton drurin e problemit në tabelë. Fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë drurin e problemit me ndihmën e mësimdhënësit.

Dëgjon nxënësit për shpjegimet e bëra.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Formoni 4 fjali me pjesëza të thjeshta;

Grupi II - Formoni 4 fjali me pjesëza të përngjitura;

Grupi III - Formoni 5 fjali me pjesëza shprehje;

Grupi IV - Formoni 5 fjali me pjesëza të thjeshta dhe të përngjitura.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë pjesëzat.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit dallojnë pjesëzat dhe i klasifikojnë sipas ndërtimit.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në vendet e lëna bosh vendosin njërën nga këto pjesëza (veç, madje, vallë, ndoshta, gjë, ë, edhe).

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë pjesëzat dhe thonë llojin e tyre.

Hapi II - Veprimtari individuale

Nxënësit punojnë me kujdes detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi kontrollon dhe vlerëson.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Formoni 4 fjali me pjesëza që të jenë fjalë të përngjitura

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- përkufizojnë pjesëzën;
- përkufizojnë pjesëzat e thjeshta, të përngjitura, shprehje;
- emërtojnë pjesëzat sipas domethënies.

Niveli i mesëm

- dallojnë pjesëzat;
- dallojnë pjesëzat e thjeshta, të përngjitura, shprehje;
- dallojnë pjesëzat sipas domethënies.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali me pjesëzat e thjeshta, të përngjitura, shprehje;
- krijojnë vetë fjali me pjesëza sipas domethënies;
- krijojnë fjali me pjesëzat.

Aktivitetet e mësimit

- lexojnë shembuj nga teksti mësimor;
- ushtrojnë pjesëzat e thjeshta, të përngjitura, shprehje;
- komentojnë për pjesëzat sipas domethënies;
- krijojnë vetë fjali me pjesëzat.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga libri;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 27

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Pasthirrma.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: INSERT, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: të parme, jo të parme etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë dhe kuptojë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës:

- pasthirrmën;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën INSERT;
- lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- identifikojnë pasthirrmat;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë pjesën nga teksti mësimor;
- shpjegon pasthirrmën ;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë pjesën nga teksti mësimor dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat.

Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Pasthirrma

Që nxënësi të punojë si duhet i orienton si të punojnë me librin: të lexojnë tekstin, të analizojnë shembujt dhe të punojnë me kujdes.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Pasthirrma është ajo klasë e pandryshueshme fjalësh, që shërben për të shprehur ndjenjat, dëshirën apo vullnetin e folësit, ose për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.

Sa i përket prejardhjes së tyre pasthirrmat mund të jenë:

1. të parme

2. jo të parme

Pasthirrmat sipas domethënies në dy grupe: emocionale dhe urdhërore.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi fton nxënësit të shkruajnë disa fjali dhe të dallojnë pasthirrat.

Nxënësit shkruajnë fjalitë dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Bëjnë plotësime, sqarime.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 2 fjali me pasthirrma si fjalë të parme;

Grupi II - Krijoni 2 fjali me pasthirrma si fjalë jo të parme;

Grupi III - Krijoni 3 fjali me pasthirrma si fjalë të parme dhe jo të parme;

Grupi IV - Krijoni 3 një tekst duke përdorur pasthirrma si fjalë të parme dhe jo të parme;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna nënvizojnë pasthirrat.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna gjejnë pasthirrat dhe thonë nëse janë fjalë të parme apo jo të parme. Nëse janë fjalë jo të parme thonë si janë formuar.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit plotësojnë vendet e lëna bosh.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna gjejnë pasthirrat dhe i shkruajnë në tabelë.

Hapi II – Veprimtari individuale

Nxënësit punojnë ushtrimet sipas kërkesave.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst me pasthirra si fjalë të parme dhe jo të parme.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- përkufizojnë pasthirmën;
- përkufizojnë pasthirrat emocionale;
- emërtojnë patharmat urdhërore.

Niveli i mesëm

- dallojnë pasthirmën;
- dallojnë llojet e pasthirmave emocionale;
- dallojnë llojet e pasthirmave urdhërore.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali me pasthirra;
- krijojnë vetë fjali me llojet e pasthirmave emocionale;
- krijojnë vetë fjali me llojet e pasthirmave urdhërore.

Aktivitetet e mësimit

- lexojnë shembuj nga teksti mësimor;
- ushtrojnë llojet e pasthirmave emocionale dhe urdhërore;
- komentojnë për pasthirmën;
- krijojnë vetë fjali me pasthirra.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 28

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Ftesa.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,
Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh; rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: ftesë etj.

Arritjet e të nxënësve:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:
- të njohë dedikimin dhe rëndësinë e teksteve të shkurtra zyrtare dhe jozyrtare:

Veprimtaritë e nxënësve:

- u përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- identifikojnë ftesën;
- identifikojnë llojet e ftesave;
- plotësojnë ftesën në tekstin mësimor;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- paraqet në televizor pyetjet e përgatitura në power point;
- shpjegon ftesën;
- fton nxënësit të plotësojnë ftesën në tekstin mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Stuhi mendimesh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi lëshon në televizor disa pyetje të përgatitura me power point.

Paraqet edhe disa ftesa.

Nxënësit vështrojnë me kujdes ftesat dhe u përgjigjen pyetjeve.

Realizim kuptimi

Hapi I- Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Ftesa

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Ftesa është një kërkesë formale ose joformale që shërben për të ftuar dikë që të marrë pjesë në një ngjarje, në një aktivitet apo në ndonjë veprimtari të caktuar.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po

Jo

_____ Përgjigjen pyetjeve _____

Nxënësit shikojnë me kujdes elementet e ftesës në librin e nxënësit. I lexojnë me kujdes dhe pyesin mësimdhënësin sipas nevojës. Nxënësit plotësojnë ftesën në tekstin mësimor. Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjitha grupet shkruajnë një ftesë duke u nisur nga elementet e ftesës.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Pyetje:

1. Çfarë është ftesa?
2. Për çfarë shërben një ftesë?
3. Cilat janë elementet themelore të një ftese?
4. Cilat janë llojet kryesore të ftesave?
5. Gjeni një ftesë e dalloni në të elementet themelore.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve me kujdes dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën

Detyrë shtëpie: Shkruani një ftesë.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 29

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Ftesa zyrtare dhe ftesa jozyrtare.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: di, dua të di, mësova, stuhi mendimesh, diagrami i venit;

Fjalët kyçe: zyrtare, jozyrtare etj.

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mëimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë:

- ftesa jozyrtare dhe zyrtare;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë ftesën zyrtare dhe jozyrtare
- identifikojnë llojet e ftesave zyrtare dhe jozyrtare;
- plotësojnë diagramin e venit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon ftesën zyrtare dhe jozyrtare;
- fton nxënësit të shikojnë llojet e ftesave në tekstin mësimor
- fton nxënësit të plotësojnë diagramin e venit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mëimit

Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Ftesa zyrtare dhe ftesa jozyrtare	Ftesa	Ftesa zyrtare dhe ftesa jozyrtare	

Nxënësit plotësojnë tabelën di, dua të di, kurse mësova në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Ftesa zyrtare dhe ftesa jozyrtare

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Nxënësit shikojnë me kujdes në tekstin mësimor karakteristikat e ftesës zyrtare dhe jozyrtare.


Ftesa zyrtare është një dokument formal që përdoret për të ftuar dikë në një ngjarje apo aktivitet të rëndësishëm, që kërkon një nivel të lartë formaliteti dhe sjellje profesionale.

Ftesat jozyrtare është një dokument që përdoret për të ftuar dikë në ngjarje që nuk kërkojnë formalitet të lartë dhe janë zakonisht për raste më të përditshme e miqësore.

Nxënësit shikojnë me kujdes shembujt e dhënë në librin e nxënësit dhe flasin për llojet e ftesave.

Hapi II - Diagrami i Venit

Nxënësit plotësojnë diagramin e Venit duke shkruar ndryshimet.



Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi 1 - Shkruani një ftesë zyrtare

Grupi 2 - Shkruani një ftesë jozyrtare

Grupi 3 - Shkruani një ftesë zyrtare

Grupi 4 - Shkruani një ftesë jozyrtare

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Pyetje:

1. Çfarë është ftesa zyrtare?

2. Cilat janë karakteristikat kryesore të tyre?
3. Çfarë është ftesa jozyrtare?
4. Cilat janë karakteristikat kryesore të tyre?
5. Gjeni nga një shembull për secilin lloj.
6. Përmendni llojet kryesore të ftesave zyrtare dhe të atyre jozyrtare.

Hapi II – Punë individuale

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ftesë zyrtare.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë ftesën;
- emërtojnë elementet themelore të ftesës;
- përkufizojnë ftesën zyrtare dhe jozyrtare.

Niveli i mesëm

- dallojnë elementet themelore të ftesës;
- dallojnë ftesën zyrtare;
- dallojnë ftesën jozyrtare.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë një ftesë;
- krijojnë vetë një ftesë zyrtare;
- krijojnë vetë një ftesë jozyrtare.

Aktivitetet e mësimit

- në tekst vërejnë ftesën;
- ushtrojnë llojet e ftesave zyrtare dhe jozyrtare;
- komentojnë për llojet e ftesave zyrtare dhe jozyrtare;
- krijojnë ftesa zyrtare dhe jozyrtare.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 30

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Ndryshimet tingullore.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, druri i problemit;

Fjalët kyçe: zanore, bashkëtingëllore etj.

Arritjet e të nxënësve:

- Gjatë mësimit nxënësi do:
- të përvetësojë njohuri për:
- apofoninë (a->o: dal:dola. marr:mora, e->o mbledh:mblodha, vjel:vola, them:thotë)

Veprimtaritë e nxënësve:

- U përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- identifikojnë apofoninë dhe metafoninë;
- shikojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- punojnë me metodën druri i problemit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësuesit:

- fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- shpjegon apofoninë dhe metafoninë;
- fton nxënësit të shikojnë ushtrimet në tekstin mësimor;
- fton nxënësit të punojnë me metodën druri i problemit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Stuhi mendimesh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi paraqet në televizor disa pyetje të përgatitura me power point dhe fton nxënësit të përgjigjen.

Nxënësit vështrojnë me kujdes pyetjet dhe u përgjigjen me kujdes.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Ndryshimet tingullore

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.


Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Ndrrimet kryesore të zanoreve janë: apofonia dhe metafoia.

Ndërrimet kryesore të bashkëtingëlloreve janë: qiellzorizimi dhe rotacizmi.

Nxënësit punojnë në tabelë shembujt të ndryshëm për apofoninë dhe metafoinë.

Hapi II - Druri i problemit



Nxënësit lexojnë me kujdes shembujt nga teksti mësimor.

Mësimdhënësi vizaton drurin problemit dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë drurin e problemit.

Dëgjon nxënësit për shpjegimet e bëra.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjitha grupet shkruajnë shembuj të apofonisë dhe metafoisë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Pyetje:

1. Kur kemi ndryshime tingullore?
2. Ku ndeshen më shumë këto ndryshime?
3. Ç'është apofonia?
4. Ku shfaqet ajo?
5. Si formohet apofonia në gjuhën shqipe?
6. Jepni shembuj të apofonisë.
7. Ç'është metafoia?
8. Si shfaqet metafoia në gjuhën shqipe?

9. Ku shfaqet ajo?

10. Jepni shembuj të metafonisë.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë përgjigjet me kujdes dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani shembuj të metafonisë.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 31

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Qiellzorizimi dhe rotacizmi.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: di dua të di, mësova, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: zanore, bashkëtingëllore etj.

Arritjet e të nxëniet:

- Gjatë mëimit nxënësi do:
- të përvetësojë njohuri për:
- palatalizimin (qiellzorëzimin), labializimin (buzorëzimin), metatezën etj.;
- rotacizmin;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë qiellzorizimin dhe rotacizmin;
- shikojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon qiellzorizimin dhe rotacizmin;
- fton nxënësit të shikojnë ushtrimet në tekstin mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mëimit

Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë.

Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Qiellzorizimi dhe rotacizmi	Apofonia, metaforia	Qiellzorizimi dhe rotacizmi	

Nxënësit në fund të orës mësimore plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Qiellzorizimi dhe rotacizmi

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Mësimdhënësi shpjegon:

Qiellzorizimi (palatalizimi) është një nga proceset më të rëndësishme fonetike që ka ndikuar në zhvillimin e gjuhës shqipe.

Rotacizmi është një fenomen i rëndësishëm historik dhe dialektor, që ka ndodhur kryesisht në dialektin toskë, duke sjellë dallime të dukshme me dialektin gegë.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Nxënësit lexojnë me kujdes shembujt nga teksti mësimor dhe pyesin mësimdhënësin sipas nevojës.

Nxënësit punojnë në tabelë shembujt të ndryshëm për qiellzorizimin dhe rotacizmin.

Mësimdhënësi vazhdon të sqaroj përmes pyetjeve dhe përgjigjeve.

Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve për të vështuar dhe analizuar me shembujt e dhënë.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjitha grupet shkruajnë shembujt të qiellzorizimit dhe rotacizmit.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Pyetje:

1. Ç'është qiellzorizimi?
2. Cilat janë tingujt që qiellzorizohen në gjuhën shqipe?
3. Jepni shembujt të qiellzorizimit për çdo tingull që qiellzorizohet.
4. Ç'farë fenomeni është rotacizmi?
5. Ç'është rotacizmi?
6. Jepni shembujt të rotacizmit.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani shembuj të rotacizmit.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë apofoninë dhe metafoninë;
- emërtojnë qiellzorizimin dhe rotacizmin.

Niveli i mesëm

- dallojnë apofoninë dhe metafoninë;
- dallojnë qiellzorizimin dhe rotacizmin. ;

Niveli i lartë

- krijojnë shembuj të apofonisë dhe metafonisë;
- krijojnë shembuj të qiellzorizimit dhe rotacizmit.

Aktivitetet e mësimit

- në tekst vërejnë shembuj të ndryshimeve tingullore;
- ushtrojnë llojet e ndryshimeve tingullore;
- komentojnë për ndryshimet tingullore;
- krijojnë shembuj të apofonisë dhe metafonisë;
- krijojnë shembuj të qiellzorizimit dhe rotacizmit.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 32

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Fjala dhe fjalia.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari trepjesësh, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: emërtuese, shërbyese etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe sqarojë strukturën e fjalisë së thjeshtë;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me ditarin trepjesësh;
- identifikojnë fjalinë;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin trepjesësh;
- shpjegon fjalinë;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime sipas nevojës;

Organizimi i orës së mësimimit

Evokim

Hapi I - Ditari trepjesësh/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet: Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin trepjesësh.

Shkruan pyetjet dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Detyra	Përgjigje	Komenti i mësimit
Fton nxënësit të lexojnë me vëmendje tekstin, të dallojnë fjalitë dhe të mundohen të tregojnë se çfarë kumtojnë ato.		

Nxënësit me kujdes plotësojnë ditarin trepjesësh me ndihmën e mësimit.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Fjala dhe fjalia

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Mësimdhënësi shpjegon:

Për çdo gjuhë fjala është një grup tingujsh apo një tingull i të folurit i formësuar gramatiksht, që shënon një send, dukuri, cilësi, veprim etj.; ose shpreh qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë.

Por ne nuk mund të komunikojmë vetëm me fjalë, pa i lidhur ato në fjali sipas rregullave të gjuhës që përdorim.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi fton nxënësit lexojnë me kujdes shembujt nga libri i nxënësit dhe të punojnë. Nxënësit dallojnë fjalët emërtuese dhe fjalët shërbyese dhe i punojnë në tabelë.

Bëjnë diskutime, plotësime, sqarime.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjitha grupet shkruajnë fjali të ndryshme dhe i komentojnë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I – Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit lexojnë tekstin dhe dallojnë fjalët sipas ndarjes që mësuam:

a). në fjalë emërtuese (të kuptimshme), b). në fjalë shërbyese:

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në shembujt e dhënë gjejnë rastet kur fjalët përdoren në rolin e fjalive.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit tregojnë se çfarë shprehin fjalitë e dhëna.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit lexojnë me vëmendje pjesën dhe dallojnë fjalitë që shprehin pohime nga ato që shprehin mohime.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes ushtrimet dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani shembuj të fjalive që shprehin pohime dhe mohime.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 33

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Fjalitë sipas ndërtimit.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: di dua të di, mësova, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: të thjeshta, të zgjeruara etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe sqarojë strukturën e fjalisë së thjeshtë;
- të njohë dhe sqarojë strukturën e fjalisë së zgjeruar;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë fjalinë e thjeshtë dhe të zgjeruar;
- lexojnë fjalitë nga teksti mësimor;
- vështrojnë me kujdes shembujt nga teksti mësimor;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon fjalitë sipas ndërtimit;
- fton nxënësit të lexojnë fjalitë nga teksti mësimor;
- fton nxënësit të shikojnë ushtrimet në tekstin mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme;

Organizimi i orës së mësimimit

Evokim

Hapi I - di, dua të di, mësova/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Fjalitë sipas ndërtimit	Fjala dhe fjalia	Për fjalinë e thjeshtë dhe të zgjeruar	

Nxënësit në fund të orës mësimore plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Fjalitë sipas ndërtimit

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Fjalitë për nga ndërtimi i klasifikojmë:

- të thjeshta
- të përbëra

Kur fjalia përbëhet vetëm nga dy gjymtyrët kryesore, quhet fjali e thjeshtë e vogël.

Kur fjalia përveç dy gjymtyrëve kryesore ka edhe gjymtyrë të dyta, quhet fjali e thjeshtë e zgjeruar.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Nxënësit lexojnë tekstin nga libri i nxënësit i ndajnë fjalitë me një vijë dhe mundohen të dallojnë gjymtyrët që i përbëjnë ato.

Nxënësit lexojnë me kujdes shembujt nga libri i nxënësit dhe pyesin mësimdhënësin sipas nevojës.

Fton nxënësit punojnë në tabelë fjali të thjeshta dhe të zgjeruara.

Mësimdhënësi vazhdon të sqarojë përmes pyetjeve dhe përgjigjeve.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Shkruani 2 fjali të thjeshta;

Grupi II - Shkruani 2 fjali të thjeshta të zgjeruara;

Grupi III - Shkruani 3 fjali të thjeshta;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit formojnë fjali të thjeshta të vogla, duke i bashkuar sipas kuptimit emrat dhe foljet në dy shtyllat (kryefjalën me kallëzuesin).

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit lexojnë tekstin dhe dallojnë gjymtyrët kryesore dhe ato të

dyta, duke i nënvizuar të parat me një vijë, kurse të dytat me vijë të ndërprerë.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në pjesën e dhënë dallojnë fjalitë e thjeshta të vogla dhe fjalitë e thjeshta të zgjeruara.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna gjejnë kallëzuesit; dallojnë fjalinë bërthamë, fjalitë e thjeshta të zgjeruara si dhe fjalitë e përbëra.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes ushtrimet dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani 4 fjali të zgjeruara.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë fjalinë;
- emërtojnë fjalinë e thjeshtë;
- përkufizojnë fjalinë e thjeshtë të zgjeruar.

Niveli i mesëm

- dallojnë fjalitë;
- dallojnë fjalinë e thjeshtë;
- dallojnë fjalinë e thjeshtë të zgjeruar.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë fjali;
- krijojnë vetë fjali të thjeshta;
- krijojnë vetë fjali të thjeshta të zgjeruara.

Aktivitetet e mësimit

- në tekst vërejnë llojet e fjalive;
- ushtrojnë llojet e fjalive të thjeshta;
- komentojnë për llojet e fjalive të thjeshta të zgjeruara;
- krijojnë fali të thjeshta dhe të thjeshta të zgjeruara.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 34

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Arsyetimi.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: di, dua të di, mësova, stuhi mendimesh, diagrami i venit;

Fjalët kyçe: zyrtar, jozyrtar etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë:

- arsyetimi jozyrtar dhe zyrtar;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë arsyetimin;
- identifikojnë arsyetimin zyrtar dhe jozyrtar;
- plotësojnë diagramin e Venit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimdhënësit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua të di, mësova;
- shpjegon arsyetimin zyrtar dhe jozyrtar;
- fton nxënësit të plotësojnë diagramin e Venit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;
- jep sqarime kur është e nevojshme.

Organizimi i orës së mësimimit

Evokim

Hapi I- Di, dua të di, mësova/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Arsyetimi	Ftesa zyrtare dhe jozyrtare	Për fjalinë e thjeshtë dhe të zgjeruar	Arsyetimi

Nxënësit në fund të orës mësimore plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Arsyetimi

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Arsyetimi është një proces mendor që përdoret për të nxjerrë përfundime ose për të marrë vendime bazuar në informacionin dhe në provat që kemi në dispozicion.

Dallojmë dy lloj arsyetimesh: zyrtar dhe jozyrtar


Arsyetimi përdoret në shkencë, në filozofi dhe në jetën e përditshme.

Nxënësit në mënyrë individuale flasin për llojet e arsyetimeve.

Hapi II - Diagrami i venit

Mësimdhënësi vizaton diagramin e venit dhe fton nxënësit të shkruajnë ndryshimet.

Nxënësit plotësojnë diagramin e venit duke shkruar ndryshimet.



Hapi III- Punë grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi 1 - Shkruani një arsyetim zyrtar;

Grupi 2 - Shkruani një arsyetim jozyrtar;

Grupi 3 - Shkruani një arsyetim zyrtar;

Grupi 4 - Shkruani një arsyetim jozyrtar;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Pyetje:

1. Ç'është arsyetimi zyrtar?
2. Ku përdoret arsyetimi?
3. Sa lloje arsyetimi kemi?
4. Ç'është arsyetimi zyrtar dhe ku përdoret ai?
5. Ç'është arsyetimi jozyrtar dhe ku përdoret ai?

6. Bëni krahasimin midis arsytimit zyrtar dhe atij jozyrtar.
7. Gjeni nga një shembull për secilin lloj arsytimi.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes përgjigjet nga teksti mësimor.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një arsytim.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë arsyetimin;
- emërtojnë arsyetimin zyrtar dhe jozyrtar;
- përkufizojnë arsyetimin zyrtar dhe jozyrtar.

Niveli i mesëm

- dallojnë arsyetimin;
- dallojnë arsyetimin zyrtar;
- dallojnë arsyetimin jozyrtar.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë një arsyetim;
- krijojnë vetë një arsyetim zyrtar;
- krijojnë vetë një arsyetim jozyrtar.

Aktivitetet e mësimit

- ushtrojnë llojet e arsyetimit zyrtar dhe jozyrtar;
- komentojnë për llojet e arsyetimit;
- krijojnë vetë lloje të arsyetimeve;
- bëjnë krahasimin ndërmjet arsyetimit zyrtar dhe jozyrtar.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 35

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Kundrinori. Kundrinori i drejtë.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: INSERT, stuhi mendimesh; rrjeti diskutimit;

Fjalët kyçe: kundrinor i drejtë etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë:

- kundrinorin e drejtë;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën INSERT;
- lexojnë tekstin nga libri i nxënësit;
- identifikojnë kundrinorin e drejtë;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Veprimtaritë e mësimit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë tekstin nga libri i nxënësit;
- shpjegon kundrinorin e drejtë;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimimit

Evokim

Hapi I- INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë tekstin nga libri i nxënësit dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat.

Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Kundrinori. Kundrinori i drejtë
Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.
Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, që vjen pas kryefjalës dhe kallëzuesit.
Kundrinori i drejtë është gjymtyrë e dytë e fjalisë, e cila shënon objektin tek i cili kalon
veprimi i shprehur nga folja.

Kundrinori i drejtë shprehet me emër, përemër dhe me grup emëror në rasën kallëzore.

Hapi II - Rrjeti i diskutimit

Po _____ Jo _____
Përgjigjen pyetjeve _____

Fton nxënësit të lexojnë shembujt nga libri i nxënësit dhe të punojnë.
Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve për të vështuar dhe analizuar shembujt e ndryshëm.
Mësimdhënësi sqaron kur është e nevojshme.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat
me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit,
i cili do të prezantojë detyrën.

Secili grup krijon 3 fjali me kundrinor të drejtë.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së
bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga
mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ush-
trimeve. Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit punojnë në fletore ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor. Mësimdhënësi i
dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni kundrinorin e drejtë.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Planifikim ditor 36

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Kundrinori i zhdrejtë.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: di dua të di, mësova, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: kundrinore, me parafjalë etj.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- kundrinorin e zhdrejtë;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë kundrinorin e zhdrejtë me dhe pa parafjalë;
- lexojnë me kujdes fjalitë nga libri i nxënësit dhe mundohen të tregojmë se çfarë funksioni kryejnë fjalët me shkronja të pjerrëta.
- lexojnë me kujdes shembujt nga teksti mësimor;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësimdhënësit:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën di, dua, të di, mësova;
- shpjegon kundrinorin e zhdrejtë;
- fton nxënësit të lexojnë fjalitë nga libri i nxënësit;
- fton nxënësit të vështrojnë shembujt nga teksti mësimor;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor;

Organizimi i orës së mëimit

Evokim

Hapi I - Di, dua të di, mësova/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Kundrinori i zhdrejtë	Për kundrinorin e drejtë	Për kundrinorin e zhdrejtë	

Nxënësit në fund të orës mësimore plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Kundrinori zhdrejtë

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapi me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Mësimdhënësi shpjegon:

Kundrinori i zhdrejtë ndahet

pa parafjalë
(kujt? cilit? cilës? cilëve? cilave?)

me parafjalë

Hapi II - Stuhi mendimesh

Fton nxënësit lexojnë me kujdes fjalitë në tekstin mësimor dhe mundohen të tregojnë se çfarë funksioni kryejnë fjalët me shkronja të pjerrëta.

Nxënësit lexojnë me kujdes shembujt nga libri i nxënësit dhe pyesin mësimdhënësin sipas nevojës.

Nxënësit punojnë në tabelë fjali duke gjetur kundrinorin e zhdrejtë me dhe parafjalë, dhe tregojnë se me çka shprehet.

Bëjnë diskutime, sqarime, plotësime.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Shkruani 2 fjali me kundrinor të zhdrejtë me parafjalë dhe tregoni me se shprehen;

Grupi II - Shkruani 2 fjali me kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë dhe tregoni me se shprehen;

Grupi III - Shkruani një tekst dhe nënvizoni kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë dhe tregoni me se shprehen;

Grupi IV - Shkruani një tekst dhe nënvizoni kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë dhe tregoni me se shprehen;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë kundrinorët dhe i shkruajnë në tabelë sipas llojit.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit dallojnë kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë e tregojnë me se shprehen.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në fjalitë e dhëna në kllapa ju duhet t'i përshtatni kundrinorët nga ana gramatikore që fjalitë të jenë të rregullta. Thoni llojin e tyre.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në tekstin e dhënë plotësojnë vendet e lëna bosh me kundrinorët në kllapa.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë ushtrimet, dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Mësimdhënësi pyet nxënësit pasi të kenë përfunduar ushtrimet se çfarë kanë mësuar dhe plotëson pjesën e fundit të tabelës mësova në bazë të përgjigjeve.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni kundrinorin e zhdrejtë.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë kundrinorin e drejtë;
- emërtojnë kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë;
- emërtojnë kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë.

Niveli i mesëm

- dallojnë kundrinorin e drejtë;
- dallojnë kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë;
- dallojnë kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë shembuj me kundrinorin e drejtë;
- krijojnë vetë shembuj me kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë;
- krijojnë vetë shembuj me kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë.

Aktivitetet e mësimit

- ushtrojnë kundrinorin e drejtë, të zhdrejtë me dhe pa parafjalë;
- komentojnë për kundrinorin e drejtë, të zhdrejtë me dhe pa parafjalë;
- krijojnë vetë fjali me kundrinorin e drejtë, të zhdrejtë me dhe pa parafjalë.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 37

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Përcaktori.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe;

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.;

Metodat dhe teknikat e realizimit: INSERT, druri i problemit, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: me përshtatje, me bashkim, me drejtim etj.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë:

- përcaktorin;

Veprimtaritë e nxënësve:

- punojnë me metodën INSERT;
- lexojnë tekstin në dy forma nga libri i nxënësit;
- identifikojnë përcaktorin;
- identifikojnë përcaktorët me përshtatje, bashkim, me drejtim;
- punojnë me metodën druri i problemit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë tabelën e INSERTIT;
- fton nxënësit të lexojnë tekstin në dy forma nga libri i nxënësit;
- shpjegon përcaktorin;
- fton nxënësit të punojnë me metodën druri i problemit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mëimit

Evokim

Hapi I - INSERT/ Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë tekstin në dy forma nga libri i nxënësit dhe plotësojnë tabelën duke vendosur shenjat. Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga sa i kujton ai.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë : Përcaktori

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, që saktëson, sqaron apo përcakton bërthamën e grupit emëror


1. me përshtatje

2. me bashkim

3. me drejtim

Sipas mënyrës së lidhjes me gjymtyrën që përcaktojnë, dallohen këto lloje përcaktorësh:

Hapi II - Druri i problemit



Mësimdhënësi shkrua disa fjali në tabelë dhe nxit nxënësit t'i punojnë.

Mësimdhënësi vizaton drurin e problemit në tabelë. Fton nxënësit të plotësojnë.

Nxënësit plotësojnë drurin e problemit.

Dëgjon nxënësit për shpjegimet e dhëna.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Krijoni 2 fjali me përcaktorë me përshtatje;

Grupi II - Krijoni 2 fjali me përcaktorë me bashkim;

Grupi III - Krijoni 3 fjali me përcaktorë me drejtim;

Grupi IV - Krijoni një tekst dhe nënvizoni përcaktorët;

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit në tekstin e dhënë gjejnë përcaktorët dhe plotësojnë tabelën.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit dallojnë përcaktorët me përshtatje e thonë me se janë shprehur.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë përcaktorët me drejtim dhe thonë me se janë shprehur.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit gjejnë përcaktorët dhe thonë llojin e tyre.

Punohet ushtrimi 5 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësit krijojnë grupe emërore, duke u shtuar emrave bërthamë përcaktorë të llojeve të ndryshme.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit punojnë ushtrimet në mënyrë individuale.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst me pasthirrma si fjalë të parme dhe jo të parme.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë përcaktorin me përshtatje;
- emërtojnë përcaktorin me drejtim;
- emërtojnë përcaktorin me bashkim.

Niveli i mesëm

- dallojnë përcaktorin me përshtatje;
- dallojnë përcaktorin me drejtim;
- dallojnë përcaktorin me bashkim.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë shembuj me përcaktorë me përshtatje;
- krijojnë vetë shembuj me përcaktorë me drejtim;
- krijojnë vetë shembuj me përcaktorë me bashkim.

Aktivitetet e mësimit

- ushtrojnë llojet e përcaktorëve;
- komentojnë për llojet e përcaktorëve;
- krijojnë vetë fjali me lloje të përcaktorëve.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 38

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Gjuha popullore dhe gjuha standarde.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, diagrami i venit;

Fjalët kyçe: zyrtar, jozyrtar etj.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mëimit nxënësi do jetë në gjendje të njohë:

- të krijojë tekste të ngjashme (sipas shembullit), duke pasur kujdes për lexueshmërinë, bukurinë dhe rregullsinë e shkrimit;

Veprimtaritë e nxënësve:

- u përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- identifikojnë gjuhën popullore dhe gjuhën standarde;
- plotësojnë diagramin e venit;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësuesit:

- fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve të përgatitura me power point;
- shpjegon gjuhën popullore dhe gjuhën standarde;
- fton nxënësit të plotësojnë diagramin e venit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mëimit

Evokim

Hapi I - Stuhi mendimesh/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi lëshon në televizor një tekst në gjuhën popullore të përgatitura me power point. Përmes pyetjeve nxit nxënësit të përgjigjen.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri /Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Gjuha popullore dhe gjuha standarde

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit

Gjuha popullore është forma e gjuhës që përdoret nga njerëzit në jetën e përditshme dhe në komunikimet e zakonshme.


Gjuha standarde është varianti i një gjuhe që është rregulluar dhe normuar për përdorim në komunikime zyrtare, arsimore dhe publike.

Nxënësit lexojnë me kujdes karakteristikat themelore të gjuhës popullore dhe flasin se ku përdoret.

Hapi II - Diagrami i Venit

Mësimdhënësi vizaton në tabelë diagramin e venit.

Nxënësit plotësojnë diagramin e venit me ndihmën e mësimdhënësit.



Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjithë grupet shkruajnë një tekst në gjuhën popullore dhe e kthejnë në gjuhën standarde. Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Pyetje:

1. Ç'është gjuha popullore?
2. Nga se përbëhet ajo dhe çfarë përfshin?
3. Cilat janë karakteristikat kryesore të gjuhës popullore?
4. Ky përdoret ajo?
5. Sillni shembuj të gjuhës popullore.
6. Ç'është gjuha standarde?
7. Çfarë përfaqëson ajo?
8. Cili është roli i saj?
9. Cilat janë karakteristikat themelore të gjuhës standarde?
10. Ky përdoret ajo?
11. Cilat janë dallimet midis gjuhës popullore dhe gjuhës standarde?

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes përgjigjet dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst në gjuhën standarde.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë gjuhën popullore;
- emërtojnë gjuhën standarde.

Niveli i mesëm

- dallojnë gjuhën popullore;
- dallojnë gjuhën standarde.

Niveli i lartë

- gjejnë shembuj të gjuhës popullore;
- krijojnë vetë shembuj të gjuhës standarde.

Aktivitetet e mësimit

- komentojnë për gjuhën popullore dhe gjuhën standarde;
- gjejnë një tekst në gjuhën popullore dhe e analizojnë.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

Planifikim ditor 39

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa: VII

Fusha: Gjuhë

Njësia mësimore: Rrethanori.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe,

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.,

Metodat dhe teknikat e realizimit: ditari trepjesësh, stuhi mendimesh;

Fjalët kyçe: pjesore, paskajore, mohore, përcjellore etj.

Arritjet e të nxënit:

- Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë;
- Gjymtyrët e dyta të fjalisë, rrethanorin;

Veprimtaritë e nxënësve:

- plotësojnë ditarin trepjesësh;
- identifikojnë rrethanorin;
- identifikojnë llojet e rrethanorëve;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Veprimtaritë e mësimeve:

- fton nxënësit të plotësojnë ditarin trepjesësh;
- shpjegon rrethanorin;
- fton nxënësit të vështrojnë ushtrimet nga libri i nxënësit;
- ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat;
- dëgjon me kujdes punën e grupeve dhe ndihmon gjatë përgjigjeve;
- fton nxënësit të punojnë detyrat nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim

Hapi I - Ditari trepjesësh/Veprimtari paraprake

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet: Mësimeve vizaton ditarin trepjesësh në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë.

Detyra	Përgjigja	Komenti i mësimeve
Lexoni tekstin për Ulqinin dhe thoni çfarë tregojnë fjalët me shkrim të pjerrët. Jepni mendime cilat fjalë plotësojnë.		

Nxënësit plotësojnë ditarin trepjesësh me ndihmën e mësimeve.

Realizim kuptimi

Hapi I - Informacion i ri/ Veprimtari me tekstin mësimor

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë: Rrethanori

Fton nxënësit të hapin tekstin mësimor.

Nxënësit hapin me kujdes tekstin mësimor dhe dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Rrethanorët janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Ata u përgjigjen pyetjeve: *ku?, nga?, kur?, si?, pse?, përse?, sa?*

Rrethanorët ndahen në:

vendi	kohe	mënyre	shkaku	qëllimi	sasie
-------	------	--------	--------	---------	-------

Hapi II - Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi vazhdon të sqaroj për llojet e rrethanorëve përmes pyetjeve dhe përgjigjeve.

Nxënësit vështrojnë me kujdes shembujt nga teksti mësimor..

Rëndësi ka aktivizimi i nxënësve për të vështuar dhe analizuar shembujt e ndryshëm.

Hapi III - Punë në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Shkruaj 3 fjali me rrethanorë kohe

Grupi II - Shkruaj 3 fjali me rrethanorë vendi

Grupi III - Shkruaj 3 fjali me rrethanorë qëllimi

Grupi IV - Shkruaj 3 fjali me rrethanorë shkaku

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim

Hapi I - Veprimtari me tekstin mësimor

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Mësimdhënësi i fton nxënësit të punojnë ushtrimet sipas kërkesave nga teksti mësimor.

Hapi II - Punë individuale

Nxënësit i punojnë me kujdes ushtrimet dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i dëgjon me vëmendje dhe vlerëson nxënësit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e sakta dhe njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni llojet e rrethanorëve.

Vërejtjet e mësimdhënësit për realizimin: _____

Përcjellje dhe vlerësim sipas niveleve pas çdo kapitulli

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VII

Rezultatet e të mësuarit (kriteret e vlerësimit)

Niveli i ulët

- emërtojnë rrethanorin e vendit dhe kohës;
- emërtojnë rrethanorin e mënyrës dhe shkakut;
- emërtojnë rrethanorin e qëllimit dhe sasisë.

Niveli i mesëm

- dallojnë rrethanorin e vendit dhe kohës;
- dallojnë rrethanorin e mënyrës dhe shkakut;
- dallojnë rrethanorin e qëllimit dhe sasisë.

Niveli i lartë

- krijojnë vetë shembuj me rrethanorin e vendit dhe kohës;
- krijojnë vetë shembuj rrethanorin e mënyrës dhe shkakut;
- krijojnë vetë shembuj me rrethanorin e qëllimit dhe sasisë.

Aktivitetet e mësimit

- ushtrojnë llojet e rrethanorëve;
- komentojnë për llojet e rrethanorëve;
- krijojnë vetë fjali me llojet e rrethanorëve.

Detyrat për të kontrolluar

Detyra plotësuese;

Detyra saktë/pasaktë;

Detyra rutinë (pyetje përgjigje)

Detyra nga teksti mësimor;

Anët negative dhe pozitive, vlerësimi i nxënësve.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VII

TEST NR. 1

Lexoni me kujdes bisedën dhe përgjigjuni pyetjeve në vazhdim.

Lira: Përsëndetje Arta! Si je?

Arta: Përsëndetje Lira! Mirë, faleminderit. Po punoj me detyrat e gjuhës shqipe që na dha mësuesja.

Lira: Pooo, shpejt do t'i përfundoj edhe unë. A dalim dhe shetisim pak pas detyrave?

Arta: Po, mund të dalim.

Lira: Në rregull! Shihemi edhe pak.

1. A) Biseda e mësipërme është:

a. formale,

b. joformale.

Rretho përgjigjen e saktë.

(1 pikë)

B) Argumentoni përgjigjen.

(1 pikë)

2. Lexoni me kujdes fjalitë dhe tregoni llojet e përemrave të fjalët e theksuara.

1. Secili prej nesh duhet ta kërkojë të drejtën të vetvetja.

2. Ky nxënës duhet marrë shembull.

1. _____ 2. _____ (2 pikë)

3. Formoni dy fjali me përemrat im, yt.

1. _____ (1 pikë)

2. _____ (1 pikë)

4. Plotësoni tabelën.

Veta I		
Njëjës		
Rasa	Mashkullore	Femërore
emërore	im vëlla	ime motër
gjinore		
dhanore		
kallëzore		
rrjedhore		

(2 pikë)

5. A) Shkruani tre përemra të pacaktuar.

_____. (1 pikë)

B) Krijoni tri fjali me përemrat që i keni shkruar.

1. _____. (1 pikë)

2. _____ . (1 pikë)

3. _____ . (1 pikë)

6. Shkruani përemrin lidhor që nuk përdoret në rasën gjinore.

_____. (1 pikë)

7. Cilët janë përemrat pyetës?

_____. (1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VII

TEST NR. 2

1. Shkruani kriteret që duhet të përmbushë një lajm.

(1 pikë)

2. Folje ndihmëse janë ato folje të cilat shërbejnë për të formuar _____
_____. (1 pikë)

3. Shkruani foljet modale.

(1 pikë)

4. Në fjalinë: Ti qenke i djallëzuar, fjala e nënvizuar është në mënyrën:

- a. lidhore
- b. dëshirore
- c. habitore

Rrethoni përgjigjen e saktë

(1 pikë)

5. Zgjedhoni foljen lexoj në mënyrën dëftore.

Mënyra dëftore

E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejshkuar	E ardhme	E ardhme e përpame
lexoj							

(3 pikë)

6. A) Shkruani cila mënyrë paraprihet nga pjesëza të.

(1 pikë)

B) Argumentojeni me një shembull.

(1 pikë)

7. A) Në cilën mënyrë është folja e theksuar në fjalinë: Qofsh me jetë more bir!

(1 pikë)

B) Shkruani një fjali me folje në mënyrën urdhërore.

(1 pikë)

8. Është kohë e vrenjtur, bubullin e vetëtin herë pas here.

Foljet e theksuara në fjalinë e dhënë janë:

a. njëvetore

b. pavetore

Rrethoni përgjigjen e saktë

(1 pikë)

9. Shkruani çka përfshin zgjedhimi i parë, dytë dhe tretë.

(1 pikë)

10. Plotësoni tabelën duke shkruar foljen lexoj në mënyrat e pashtjelluara.

pjesore	
	për të lexuar
përcjellore	
	pa lexuar

(1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VII

TEST NR. 3

1. Çka është lajmërimi publik?

(1 pikë)

2. Shkruani llojet e ndajfoljeve në fjalitë e dhëna.

Fliste gjithnjë bukur.

Vjollca mësonte shumë mirë.

Aty ishin përqendruar të gjitha forcat tona.

(3 pikë)

3. Në cilën shkallë është ndajfolja në fjalinë: Kjo është më mirë se të shkosh pa biletë.

a. pohore

b. krahasore

c. sipërore

Rrethoni përgjigjen e saktë

4. Cili është qëllimi i raporteve?

(1 pikë)

5. A) Parafjalët: *mbi, me, ndaj, ndër, në, më, nën, pa, për, te(k), afër, sipër, rrëzë, buzë* etj.; janë:

a. të thjeshta

b. të përngjitura

c. parafjalore

Rrethoni përgjigjen e saktë

(1 pikë)

B) Argumentojeni me një shembull.

(1 pikë)

6. Në cilën klasë të fjalëve bëjnë pjesë lidhëzat?

(1 pikë)

7. Shkruani llojin e lidhëzës bashkërenditëse në fjalitë:

Iliri **as** e merr, **as** e lë.

Ditën mësonte, **kurse** natën punonte.

(2 pikë)

8. Shkruani llojin e lidhëzës nënrenditëse në fjalitë:

Tek dhemb dhëmbi, vete gjuha.

Kur ishim tek lumi, uji kishte pak rrjedhë.

Po t'i japësh gishtin, të merr dorën.

(3 pikë)

9. Shkruani një lajmërim publik.

[illegible]

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VII

TEST NR. 4

1. Çka përshkruan biografia?

(1 pikë)

2. Pranë çdo pjesëze shënoni llojin:

bash _____
posi _____
jo që jo _____
siç _____
bile _____
thujse _____
kushedi _____
s' _____
ja që _____

(2 pikë)

3. Formoni katër fjali me pjesëzat e lartshënuara...

(1 pikë)
(1 pikë)
(1 pikë)
(1 pikë)

4. Ç'është pasthirma?

(1 pikë)

5. Formoni katër fjali me lloje të pasthirmave.

(1 pikë)
(1 pikë)
(1 pikë)
(1 pikë)

6. Shkruani biografinë e një shkrimtari nga lektyra shkollore që keni lexuar në klasën e shtatë.

Biografia _____

7. Shkruani çka përfshin zgjedhimi I, II, III. (2 pikë)

I _____

II _____

III _____ (1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VII

TEST NR. 5

1. Ç'është ftesa?

(1 pikë)
2. Shkruani tri karakteristika të ftesës zyrtare.

(1 pikë)
3. Cilët janë llojet kryesore të ftesave jozyrtare.

(1 pikë)
4. Cili është roli kryesor i apofonisë dhe metafonisë?

(1 pikë)
5. Shkruani shembuj të apofonisë dhe metafonisë.

(1 pikë)
6. Cilët tingujt qiellzorizohen në gjuhën shqipe?

(2pikë)
7. Shkruani dy shembuj të rotacizmit.

(2 pikë)
8. Fjalët e një gjuhe ndahen në:
a. _____
b. _____
(1 pikë)
9. Rrethoni përgjigjen e saktë
a. Fjala nuk është njësia më e vogël e ligjërimit
b. Fjala është njësia më e vogël e ligjërimit
c. Fjala është njësia më e madhe e ligjërimit
(1 pikë)

10. Shkruani një ftesë zyrtare.

FTESE

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VII

TEST NR. 6

1. Si i klasifikojmë fjalitë për nga ndërtimi?

(1 pikë)

2. Kur fjalia përbëhet vetëm nga dy gjymtyrët kryesore, quhet:

a. fjali e thjeshtë e vogël

b. fjali e thjeshtë e zgjeruar

Rrethoni përgjigjen e saktë.

(1 pikë)

3. A) Shkruani çka është fjalia e thjeshtë e zgjeruar.

(1 pikë)

B) Argumentojeni me një shembull.

(1 pikë)

4. Shkruani ku përdoret arsyetimi.

(1 pikë)

5. Çka është arsyetimi zyrtar?

(1 pikë)

6. Arsyetimi jozyrtar përdoret: _____

(1 pikë)

7. A) Shkruani çka është përcaktori me përshtatje.

(1 pikë)

B) Argumentojeni me një shembull.

(1 pikë)

8. Shkruani dy fjali me përcaktor me drejtim dhe dy fjali me përcaktor me bashkim.

(4 pikë)

9. Cili nga arsyetimet nuk përfshin emocione?

a. zyrtar

b. jozyrtar

Rrethoni përgjigjen e saktë.

(1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VII

TEST NR. 7

1. Çka është gjuha popullore?

(1 pikë)

2. Shkruani tri karakteristika të gjuhës popullore.

(1 pikë)

3. Shkruani tri karakteristika të gjuhës standarde.

(1 pikë)

4. Cilave pyetjeve u përgjigjet kundrinori ?

(1 pikë)

5. Kundrinori ndahet në:

(1 pikë)

6. Shkruani dy fjali me kundrinor të drejtë që shprehet me përemër dhe grup emëror.

(1 pikë)

7. Shkruani një fjali me kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë.


(1 pikë)

8. Shkruani gjashtë fjali me të gjithë llojet e rrethanorëve.

(6 pikë)

9. Përmbledhje e njohurive. (rrethanori)

(1 pikë)



Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

